



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 10 (8261)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 mars 2015

BESIM FAGU, GJIGANDI I SPORTIT SHQIPTAR, THEMELUESI I KLUBIT "PARTIZANI"



Me rastin e 90 - vjetorit të lindjes së Besim Fagut, sportistit të mirënjohur, krijuesit dhe drejtuesit për disa dekada të klubit sportiv "Partizani", në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një ceremoni përkujtimore. Ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, deputetë të

Kuvendit të Shqipërisë, ish - sportistë të shquar të të gjithë llojeve të sporteve jo vetëm të klubit "Partizani", por edhe të klubeve të tjerë sportive të vendit tonë, familjarë dhe të afërm të të mirënjohurit Besim Fagu etj. Ministria e Mbrojtjes Kodheli, duke iu drejtuar të pranishmëve dhe veçanërisht bashkëshortes dhe fëmijëve të Besim Fagut, theksoi se është...

» faqe 2

NË FORCËN AJRORE Zhvillohet aktiviteti "Air C2 & NATINADS"

Qëllimi i aktivitetit ishte ofrimi i ndihmës dhe rekomandimeve teknike për Qendrën e Kontroll - Raportimit në lidhje me trajnimin e personelit operator dhe teknik

» faqe 4

CEREMONIA

Shqipëria kthen në Angli unazën e pilotit britanik, rënë gjatë LLB

Enigma e një unaze që zgjoi aq shumë mirënjohjeje njerëzore




Vizita

Gjeneralmajor Bazo priti ambasadorin britanik në Tiranë Cannon

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti në një takim të veçantë ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, z. Nicholas Cannon. Gjeneralmajor Bazo vlerësoi marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy...

» faqe 3



» faqe 3,8-9



Dossier

Historia e Gjuajtësit të Madh Detar P-207 "VJOSA"

Historia detare e Shqipërisë është e lashtë, ndërsa ajo e Forcës Detare e lavdishme. Por në këtë shkrim do të ndalemi në historikun e një prej anijeve më të fuqishme luftarake që Flota jonë Ushtarake Detare ka pasur në dispozitivin e saj luftarakë përgjatë...

» faqe 6-7



INTERVISTA

IGJU një aset i madh kombëtar

Në 40 - vjetorin e krijimit të IGJU Intervistë me ish-drejtorin, kolonel (R) Myslim Pashaj

» faqe 5

ANALIZË

Roli i naftës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe gjeopolitike

faqe 10-11

HISTORI

Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes Fan Noli, Rilindasi ynë i fundit

faqe 12



Medalja e Mirënjohjes për Besim Fagun në 90-vjetorin e lindjes

Besim Fagu, gjigandi i sportit shqiptar, themeluesi i klubit "Partizani"

Kodheli: Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura respektojnë kujtimin e personaliteteve të tillë si Besim Fagu, që krijuan për radhët e ushtarakëve shqiptarë një strukturë profesioniste sportive. Ishte Besim Fagu dhe shokët e tij që e bënë klubin "Partizani" një organizëm elitë të sportit dhe fizkulturës në Shqipëri

Me rastin e 90 - vjetorit të lindjes së Besim Fagut, sportistit të mirënjohur, krijuesit dhe drejtuesit për disa dekada të klubit sportiv "Partizani", në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një ceremoni përkujtimore. Ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, ish - sportistë të shquar të të gjithë llojeve të sporteve jo vetëm të klubit "Partizani", por edhe të klubeve të tjerë sportivë të vendit tonë, familjarë dhe të afërm të të mirënjohurit Besim Fagu etj.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, duke iu drejtuar të pranishmëve dhe veçanërisht bashkëshortes dhe fëmijëve të Besim Fagut, theksoi se është një kënaqësi e veçantë për mua që jemi mbledhur sot në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes për të kujtuar një nga gjigandët e sportit shqiptar, themeluesin e klubit "Partizani", të nderuarin Besim Fagu. Dhe kur shoh gjithë këto personalitete të shquara të sportit tonë, që janë sot të pranishëm në këtë ceremoni modeste, më vijnë para syve emocionet e fëmijërisë dhe rinisë, ku të gjithë ju, së bashku me të paharruarin Besim Fagu, ishit idhujt, mësuesit dhe shembujt për t'u ndjekur. "Ka shumë e shumë personalitete të sportit të cilët



kanë kujtime të lidhura me punën dhe përpjekjet e Besim Fagut, por për mua, si vajzë e këtij qyteti të mrekullueshëm, ai ka qenë babi i Afërditës, i Gimit dhe i Benit, por dhe një personazh që krijonte respekt pa folur asnjë fjalë", është shprehur znj. Kodheli.

Më tej, duke u ndalur në meritat e këtij personaliteti të sportit shqiptar, ministrja Kodheli tha: "A mund të ketë histori më të bukur se ajo e tre djemve tironsa, Fagu-Demneri-Bylyku, të cilët themeluan në vitin 1946 klubin sportiv "Partizani", atë që do të bëhej rivali më i madh i bardhebluve të Tironës?!

Entuziazmi i atyre viteve, me dëshirën për të krijuar mrekulli nga hiçi, është me të vërtetë për t'u admiruar". Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura respektojnë kujtimin e personaliteteve të tilla si Besim Fagu, që krijuan për radhët e ushtarakëve shqiptarë, një strukturë profesioniste sportive. Ishte Besim Fagu dhe shokët e tij që e bënë klubin "Partizani" një organizëm elitë të sportit dhe fizkulturës në Shqipëri. "Partizani" ka qenë një shkollë e jetës për shumë e shumë breza të shquar ushtarakësh e sportistësh. Shumë yje kanë dalë nga aty dhe shumë

prej jush këtu, jeni produkt i klubit "Partizani". "Si ministre e Mbrojtjes, e kam detyrim moral dhe institucional të respektoj figura të ndritura si ajo e Besim Fagut. Ju faleminderit të gjithëve për praninë!", përfundoi fjalën e saj ministrja Kodheli.

Më pas, ministrja Kodheli i ka dorëzuar bashkëshortes së të paharruarit Besim Fagu, znj. Hajdije Fagu, Medaljen e Mirënjohjes, akorduar për këtë figurë të shquar, me motivacion: "Për kontributin e dhënë në zhvillimin e lëvizjes fizkulturore sportive, përgatitjes fizike të Forcave të Arma-

tosura, si dhe themelues i klubit sportiv "Partizani".

Në vijim, gjeneral lejtënant (R) Rahman Parllaku, në fjalën e tij vlerësoi lart figurën e Besim Fagut si një sportist i shquar dhe krijues i klubit sportiv "Partizani" dhe lëvizjes sportive në ushtri. Ndërsa i biri i tij, ish - basketbollisti elitari i "Partizanit" dhe i kombëtares, Agim Fagu, solli kujtime nga jeta e Besim Fagut dhe meritat e mëdha që ka lënë në historinë e klubit sportiv "Partizani".

Besim Fagu lindi në qytetin e Tiranës në vitin 1925 dhe vdiq në vitin 1999. Fill pas luftës, ku ai ishte inkuadruar partizan, u lidh përjetësisht me ushtrinë dhe sportin. Ai është padyshim një nga lojtarët e rrallë jo vetëm në Shqipëri, por edhe më tej për numrin e madh të kampionateve të fituara me një skuadër. Besimi ka luajtur për klubin e kuq për 12 vite rresht. Mbrojtësi shtatlartë i "Partizanit" do ta mbyllte karrierën e tij të suksesshme me tre tituj rresht në 1957, 1958 dhe 1959, duke e çuar në shtatë numrin e trofeve me "Partizanin". Gjatë kësaj periudhe, përveç shtatë titujve, Besim Fagu ngriti edhe katër herë Kupën e Shqipërisë. Gjithashtu Besim Fagu ka qenë pjesë e trofeut të vetëm ndërkombëtar të Shqipërisë pasi fitoi Kupën Ballkanike me kombëtaren në 1946. Ai është themeluesi dhe drejtuesi për shumë vite i klubit sportiv "Partizani", një ndër klubet më me emër në historinë e sportit shqiptar.

Gjeneralmajor Bazo priti ambasadorin britanik në Tiranë Cannon

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, priti në një takim të veçantë ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, z. Nicholas Cannon. Gjeneralmajor Bazo vlerësoi marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve, sidomos në fushën e arsimit ushtarak në akademitë e Forcave Tokësore, Detare e Ajrore, në Kolegjin Mbretëror të Mbrojtjes, si dhe kurse të ndryshme institucionale dhe profesionale që kanë zhvilluar ushtarakët shqiptarë në Britaninë e Madhe.

Nga ana e tij, ambasadori Cannon falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, për mbështetjen e deritanishme të Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë në kuadër të stërvitjeve të përbashkëta, të zhvilluara sidomos vitet e fundit në Shqipëri. Stërvitjet e përbashkëta midis dy forcave tona të armatosura, sidomos stërvitja "Albanian Lion", ka qenë një mundësi e mirë për rritjen e nivelit të profesionalizmit dhe ndërveprueshmërisë për t'u përballuar me të gjitha sfidat që NATO ka pasur në këto vitet e fundit. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan kontributet e dy vendeve tona në kuadër të Aleancës, si kontribuese aktive në luftën kundër terrorizmit. Gjeneralmajor Bazo dhe Ambasadori Cannon shprehën gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në të ardhmen në fushat e lartpërmendura.



Shqipëria kthen në Angli unazën e pilotit britanik, rënë gjatë LLIB

Ministrja Kodheli: Rreshteri Xhon Thompson i la të dashurit e zemrës përpara kohe, jeta iu shkurtua në një fushëbetejë të largët, mijëra milje larg nga Anglia Qendrore. Por kujtimi i tij jetoi gjatë si në Angli ashtu dhe në Shqipëri, mes familjes Thompson dhe familjes Çala.

Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua një ceremoni sa e veçantë aq edhe mbresëlënëse. Në qendër të kësaj ceremonie ishte akti i dorëzimit të unazës së pilotit anglez, rreshterit Xhon Thompson, rënë në krye të detyrës gjatë Luftës së Dytë Botërore, në tetor të vitit 1944, në Kaptinë të Martaneshit. Unaza e tij ishte gjetur rastësisht rreth viteve 1960 nga Jaho Çala, i cili ia kishte lënë amanet të birit të tij, Xhemil Çala, që ta ruante me kujdes dhe kur të vinte rasti të gjente mundësinë për t'ia nisur të afërmit të tij. Në këtë unazë martese ishin të shkruar inicialet "Xhon dhe Xhois". Me ndërmjetësinë e Ambasadës Britanike në Tiranë dhe Ambasadës Amerikane u bë e mundur identifikimi i kësaj unaze dhe lidhja me familjarët në Britaninë e Madhe, të ish-pilotit të vrarë.

Ceremonia ka nisur me ekzekutimin e Himnit Kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar dhe Himnit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë. Më pas, z. Muhamet Aliçka, personi që kontaktoi me Ambasadën Britanike, tregoi shkurtimisht historinë e kësaj unaze. Folën gjithashtu edhe nipi i pilotit të vrarë britanik, z. Alan Webster, si dhe ambasadori britanik, z. Nicholas Cannon.

Duke marrë fjalën në këtë ceremoni ministrja e Mbrojtjes Kodheli, theksoi se, sot jemi mbledhur për të përkujtuar një ngjarje të trishtë të Luftës së Dytë Botërore, si shumë të ngjashme në ato ditë të errëta të njerëzimit. Rreshteri britanik Xhon Thompson, në një ditë të ftohtë të tetorit 1944 humbi jetën kur avioni i tij "Halifax" u përplas në malet shqiptare pas furnizimit që u kishte bërë njësitëve tona në luftë me okupatorin nazist. Djaloshi 23-vjeçar dha jetën për një kauzë të përbashkët dhe ne sot po kujtojmë të gjithë ata që



bënë sakrificën finale për vendet tona, po kujtojmë dëshmorët e rënë që nuk u kthyen kurrë tek miqtë dhe familjet e tyre. "Liria është një dhuratë e çmuar, të cilën ne e gëzojmë çdo ditë, por rrallë kujtojmë çmimin njerëzor që kemi paguar për ta pasur. Vetëm ata që kanë parë me sytë e tyre tmerret e

luftës, mund të arrijnë të kuptojnë momentet e fundit të jetës së ushtarakëve që luftuan për lirinë tonë. Unë shpresoj që dhimbjet e familjarëve të këtyre heronjve të rënë në fushën e betejës të lehtësohen sadopak prej faktit që ata ranë për një kauzë fisnike: çliruan miliona njerëz nga tirania mizore na-

zifashiste", u shpreh Kodheli.

Znj. Kodheli vlerësoi kontributin e madh që dhanë për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë aleatët tanë natyralë, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku operacionet ajrore britanike, të koordinuara me misionet ushtarake atashuar pranë njësitëve të rezistencës shqiptare, ishin padyshim çelësi i suksesit të fitores finale. "Sakrificat e britanikëve në Shqipëri, por dhe në gjithë Evropën Lindore, për fat të keq nuk na ndihmoi për të realizuar ëndrrën për liri e demokraci. Nga një regjim totalitar kaluam në një tjetër më të egër, që zgjati për 45 vjet të errëta. Ata që erdhën në pushtet e injoruan kontributin e aleatëve tanë anglo-amerikanë. Por shqiptarët e thjeshtë i dinin fort mirë të vërtetat e luftës. I dinin fort mirë sakrificat e përbashkëta dhe e kuptonin qartë se ata britanikë që iu atashuan formacioneve luftarake shqiptare të rezistencës, ndihmuan thelbësisht për çlirimin e vendit. Dhe njerëz të thjeshtë si Jaho Çala, të persektuar nga regjimi komunist, për asnjë moment nuk harruan vlerat e shqiptarit të vërtetë. Ndoshta kjo histori do të ishte zgjidhur më shpejt nëse Shqipëria nuk do të ishte vetëizoluar për 45 vjet. Por kjo nuk

ishte në dorën e asnjërit prej nesh këtu të pranishëm dhe të paktën, familja e rreshterit të ndjerë ka diçka për ta kujtuar. Rreshteri Xhon Thompson i la të dashurit e zemrës përpara kohe, jeta iu shkurtua në një fushëbetejë të largët mijëra milje larg nga Anglia Qendrore. Por kujtimi i tij jetoi gjatë si në Angli ashtu dhe në Shqipëri, mes familjes Thompson dhe familjes Çala", është shprehur ministrja Kodheli.

Me këtë rast, znj. Kodheli ka falënderuar përzemërsisht familjen Çala, për mbajtjen gjallë të kujtimit të një të rëni për çlirimin e Shqipërisë, Ambasadën Britanike në Tiranë për përpjekjen e gjatë për identifikimin e të ndjerit Xhon pas kaq shumë vitesh, ndërsa një falënderim të veçantë ajo përcolli për familjarët e rreshterit Thompson, për motrën e tij, znj. Webster, e cila ndonëse në një moshe të thyer ishte e pranishme në këtë ceremoni.

"Sakrificat e tij sublime do të jetë e paharruar. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij", përfundoi fjalën e saj ministrja Kodheli.

Më pas, Xhemil Çala, djali i Jaho Çalës, i dorëzoi unazën motrës së pilotit të vrarë, Xhon Thompson, znj. Dorothy Webster. Ministrja Kodheli i dorëzoi znj. Webster një kuti me një pjesë të avionit dhe gurit të malit të Sinojit, ku ishte rrëzuar më 70 vjet më parë avioni. Po kështu znj. Kodheli i akordoi "Certifikatën e Mirënjohjes" z. Jaho Çala, e cila iu dorëzua të birit, z. Xhemil Çala. Gjithashtu edhe nga pala britanike u dhanë disa dhurata simbolike, si dhe letra mirënjohje të dërguara nga Forcat Ajrore Britanike për familjen Çala. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët përballë godinës së Ministrisë së Mbrojtjes.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, z. Nicholas Cannon, nipi dhe motra e pilotit rënë në krye të detyrës Xhon Thompson, familjarë dhe të afërm të familjes Çala etj.



Ndalohet peshkatorja italiane "Cobra 3" për gjueti të paligjshme

Në pasditen e datës 10 mars, ora 17.30, nga Oficeri i Drejtimi të Forcës Detare në QNOD u dha informacioni se, një nga operatorët e QNOD kishte diktuar një peshkatore italiane me emrin "COBRA 3", e cila lundronte brenda ujërave tona territoriale në traversë të Karavastasë. Ndërkohë anija e Flotiljes sonë Detare Oriku P-132, e cila po patrullonte sipas planit në zonën e Bristanit për në Jug, drejt Palermos, u urdhërua të ndryshojë zonën e patrullimit dhe të marrë kursin për në Veri, drejt Karavastasë, për të verifikuar peshkatoren e dyshuar në këtë zonë. Në orën 21.05, peshkatorja italiane ndodhej në 40°54'91"V dhe 19°11'43"L, rreth 2.8 milje brenda ujërave tona territoriale, duke lundruar me shpejtësi 2.5-2.8 nyje. Ndërkohë anija jonë nga VP i Sazanit lundroi për në Veri, në rajonin e dhënë. Për këtë situatë u njoftua komandanti i FD, QBO, oficerët e Policisë Kufitare, Peshkimit e Doganës që ndodheshin në Sallën Operacionale të QNOD. Në orën 22.10, anija jonë P-132 shkoi në rajon dhe uli gomones dhe nisi verifikimin e peshkatores italiane me emrin në bord "Cobra 3", e cila kryente gjueti me trata fundore brenda ujërave tona. Peshkatorja kishte në përbërje të ekuipazhit 4 persona me kapitan Pjetron Di Lorenzo dhe port regjistrimi Mona Bari, Itali. Mbas pyetjeve të drejtuara nga Roja

jonë Bregdetare, kapiteni i anijes italiane pretendonte se kishin shkelur ujërat tona pa dashje, pasi po merreshin me aktivitetin e gjuetisë dhe nuk e kishin venë re këtë gje. Për këtë shkelje të ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë brenda ujërave tona territoriale, peshkatorja u ndalua dhe u urdhërua që të drejtohej për në portin e Vlorës. Peshkatorja iu bind urdhërit të komandantit të anijes "Oriku", Kapiteni i Rangut III-të Ilir Cobo, dhe nën shoqërimin e anijes sonë dhe gomones së saj u drejtua për në portin e Vlorës. Për këtë u njoftua përsëri komandanti i Forcës Detare, general brigade Qemal Shkurti, që e ndoqi "non stop" operacionin, si dhe shërbimi në QBO, Polici Kufitare, Oficeri i Shërbimit Doganor dhe ai Shërbimit të Peshkimit, që të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Vlorë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme me këtë peshkatore. Në orën 02.05, datë 11.3.2015, peshkatorja "Cobra 3" nën kontrollin e anijes "Oriku" u bregëzua në portin e Vlorës. Pas plotësimit të dokumentacionin përkatës që mbahet në këto raste, peshkatoria italiane iu dorëzua Policisë Kufitare dhe Kapitenerisë në Vlorë për të vazhduar procedurat e metejshme, ndërsa anija "Oriku" u largua nga porti i Vlorës për të vazhduar detyrat e radhës.

Shefqet Kërçelli



NË FORCËN AJRORE

Zhvillohet aktiviteti "Air C2 & NATINADS"

Mbështetur në matricën e aktiviteteve kryesore të Komandës së Forcës Ajrore, programin e miratuar nga Ministria e Mbrojtjes, në datat 3 - 5 mars 2015, në Forcën Ajrore u zhvillua aktiviteti "Air C2 & NATINADS", me pjesëmarrjen e një ekipi ekspertësh të Forcave Ajrore amerikane në Evropë. Ekipi amerikan i USAFE përbëhej nga tre ekspertë, major John C Sherinian, major Christopher D. Potter, chief master sergeant Luis A. Jr. Martinez. Qëllimi i aktivitetit ishte ofrimi i ndihmës dhe rekomandimeve teknike për Qendrën e Kontroll - Raportimit në lidhje me trajnimin e personelit operator dhe teknik, gjetjen e mundësive për sigurimin e kapaciteteve dhe pajisjeve të vëzhgimit ajror dhe komandim - kontroll - komunikimit, si dhe integrimin e pamjes ajrore dhe aseteve të komandim - kontrollit ajror të Shqipërisë në sistemin NATINADS (Integrated NATO Air Defense System).

Ditën e parë të aktivitetit ekipi u prit në takim nga shefi i shtabit i Forcës Ajrore kolonel Flamur Hadushi. Pas takimit të mirëseardhjes u vijua me zhvillimin e prezantimeve dhe diskutimeve për çështjet e këtij aktiviteti. Prezantimet dhe diskutimet e ditës së parë u ndoqën edhe nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Modernizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, kapiteni i rangut të dytë Artur Sheko. Fillimisht, nga specialistët të QKR, Rinas, u paraqitën dy prezantime për Qendrën e Kontroll - Raportimit, mbi organizimin aktual të saj, misionin dhe detyrat që realizon, si dhe për kapacitetet dhe sistemet aktuale dhe ato që priten të instalohen brenda një kohe të shkurtër në QKR, Rinas, nga projektet e përbashkëta me strukturat e NATO-s.

Ndërsa ekipi i ekspertëve amerikanë prezantoi pesë briefingje me tema



mbi komandim - kontrollin, njësitë përbërëse të sistemit të komandim - kontrollit, struktura dhe organizimi i një QKR të standardit amerikan, përdorimi dhe funksionimi i "Link 16", si dhe sistemi ACCS. Dita e dytë dhe

e tretë e aktivitetit vijoi me diskutime mbi çështjet që lidhen me funksionimin operacional të QKR, sigurimin e kapaciteteve të vëzhgimit ajror, mbrojtjes ajrore dhe komunikimit, sistemet e komandim - kontrollit dhe trajnimin e

personelit. Në përfundim të këtij aktiviteti, nga ekipi i ekspertëve amerikanë u rekomandua riorganizimi i QKR në Rinas, i përshtatur për nevojat e vendit tonë, sipas strukturës standarde të një QKR të NATO-s. Funksionimi i

QKR, Rinas, si një njësi e aftë për të operuar "Link 16", si një link i sigurtë dhe efikas i shkëmbimit të të dhënave, me qëllim ndërveprueshmërinë e plotë në strukturën e komandim - kontrollit ajror të NATO-s.

Instrukturë amerikanë trajnojnë efektivat e MADM të Forcës Tokësore

Në ambientet e garnizonit "Skënderbej", në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në fushën e mbrojtjes nga Armët Kimike, Radiologjike dhe Nukleare (CBRN), rreth 30 efektivë të Kompanisë së Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë (MADM), pjesë e Batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcave Tokësore, morën pjesë në trajnimin katër ditor me temë "Angazhimi ndaj rrezikut radioaktiv dhe Armëve të Shkatërrimit në Masë". Ky trajnim synonte të aftësonte personelin e Kompanisë së MADM në kushtet e përdorimit të armëve Kimike, Radiologjike dhe Nukleare (CBRN). Ndër objektivat kryesore në këtë aktivitet ishin:

- Njohja e armëve të CBRN dhe mjeteve mbrojtëse,
- Marrja e njohurive për kërcënimet ekzistuese të rrezikut CBRN, efektet dhe ndikimi potencial i CBRN-ve,
- Zotërimi i njohurive për trajtimin e viktimave nga armët radiologjike,
- Marrja e njohurive për procedurat e Dekontaminimit (ç'ndotjes).

Gjatë katër ditëve të këtij trajnimi, audiencia pati mundësinë të pajisjes me informacion tepër të dobishëm për detyrat që duhet të kryejnë nga instruktorët amerikanë të Agjencisë së Mbrojtjes dhe Reduktimit të Rrezikut të SHBA-së. Specialistët amerikanë zhvilluan tema të ndryshme si: Llojet e rrezikut CBRN; Ndikimet mjedisore të fatkeqësive radiologjike; Efektet psikologjike të incidentëve radiologjike; Paisjet personale të mbrojtjes radiologjike dhe nukleare; Rreziku mjekësor nga izotopet radiologjike; Profilaksia dhe trajtimi për lëndimet nga rrezatimi etj.

Zhvillimi dhe pjesëmarrja në këtë seminar ishte një ndihmesë konkrete për efektivin e Kompanisë së Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë (MADM) të Forcës Tokësore dhe shërbeu për thellimin e njohurive dhe rritjen e aftësive në lidhje me armët CBRN, kryesisht në njohjen, zbulimin dhe dekontaminimin (ç'ndotjen) nga rrezatimi radiologjik.

Kapiten Edvin Hodo

Në 40 - vjetorin e krijimit

Instituti Gjeografik dhe Infrastrukturës Ushtarake një aset i madh kombëtar

Intervistë me ish-drejtorin, kolonel (R) Myslim Pashaj

Intervistoi: Albert Z. ZHOLI

Një bisedë interesante ku koloneli i mirënjohur Myslim Pashaj tregon ideatorët kryesorë të krijimit të Institutit të Topografisë Ushtarake, ku sipas tij janë: Dhimo Dhaskali, Limos Alimuçi, Vait Tartari, Çesk Begu, Thimi Jorganxhi, Myslim Haxhiu, Filip Marga, Mulla Mullaj, të cilët ishin ndër kryesorët që punuan në këtë projekt të ri që do t'i vlente ardhmërisë së këtij shërbimi. Po nuk mund të harrohen edhe shumë të tjerë që punonin në sektorët e krijuar dhe dhanë mendime të çmuara, thekson ai. Ky Institut do të ishte institucion ushtarak kërkimor dhe prodhues në fushën e përgatitjes topografike të ushtrisë shqiptare dhe më gjerë. Në 15 mars 1975 u caktuan drejtori dhe zëvendës-drejtori: Limos Alimuçi dhe Vait Tartari dhe pas tyre vinte një bashkësi kuadrosh oficerë të shkallëve dhe të breznive të ndryshme të cilët kanë lënë jetën e tyre në vlera të mëdha hartograike dhe gjeodezike.

- Zoti kolonel, Instituti i Topografisë Ushtarake (sot Instituti i Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë) kremton 40-vjetorin e krijimit të tij. Çfarë mund të na thuash për këtë strukturë me shumë emër në Forcat tona të Armatosura?

Kjo nuk është thjeshtë një histori. Është një ngjarje që nuk sjell vetëm një datë të thjeshtë të një Instituti të zakonshëm. Kjo ngjarje sjell në histori për një nga institutet më në zë të fushës studimore dhe krijuese hartografike në Shqipëri, sepse ky Institut është marrë dhe merret me Hartën e Shqipërisë, me portretin e saj në kohë dhe hapësirë, me gjeohistorinë e këtij vendi dhe nuk i shërben vetëm FA, por gjithë spektrit zhvillimor shqiptar. Ai u krijua në 8 mars të vitit 1975. pra u mbushën plot 40 vjet.

- Ishte një situatë politike dhe ideologjike nga më dramatike në Shqipërinë komuniste, kishin filluar grupet antiparti të kohës, apo jo?

Vërtetë, ishte një tronditje e madhe jo vetëm për Ushtrinë, por edhe për gjithë vendin. Beqir Balluku ishte shpallur armik. Pas tij gjeneralet të njohur shqiptarë, që kishin ardhur nga Lufta e Dytë Botërore, shkonin pas njëri tjetrit në pushkatim (Petrit Dume, Hito Çako) dhe shumë të tjerë do të dënoheshin me burgime dhe internime. Si një shkullmë e fortë shkallmuese frynte era e të ashtuquajturave "Teza të Zeza" dhe komplete pas saj. Pikërisht në këtë kohë tronditëse, profesionistë të topografisë ushtarake, pa u ndikuar nga politika dhe ideologjia e kohës, u përveshën punës që të krijonin një Institut për t'i shërbyer hartografimit dhe gjeodezisë kombëtare. Pra, në këtë eveniment nuk ka një asnjë ndikim



ideologjik. Ishte koha që gjeodezia dhe hartografia shqiptare të krijonte profilin e saj, t'i shërbente zhvillimit. Ata që e krijuan këtë Institut nuk u nisën vetëm nga ndërmarrja fantazmë e bunkerizimit të Shqipërisë, as e koalicionëve armiqsore, por për nevojat gjithësore që kishte vendi në të gjithë fushat. Ndërkaq, specialistët më në zë të Topografisë Ushtarake vijonin misionin e tyre hartografik dhe gjeodezik kombëtar. Kishte ardhur koha që të krijohej Instituti Topografik Ushtarak.

- Kush ishin nismëtarët e tij të parë?

Ideatorët kryesor që duhet t'i përmendë historia janë: Dhimo Dhaskali, Limos Alimuçi, Vait Tartari, Çesk Begu, Thimi Jorganxhi, Myslim Haxhiu, Filip Marga, Mulla Mullaj, të cilët ishin ndër kryesorët që punuan në këtë projekt të ri, që do t'i vlente ardhmërisë së këtij shërbimi. Po nuk mund të harrohen edhe shumë të tjerë që punonin në sektorët e krijuar dhe dhanë mendime të çmuara. Ky Institut do të ishte institucion ushtarak kërkimor dhe prodhues, në fushën e përgatitjes topografike të ushtrisë shqiptare dhe më gjerë. Në 15 mars 1975 u caktuan drejtori dhe zëvendës-drejtori: Limos Alimuçi dhe Vait Tartari. Pa tyre vinte një bashkësi kuadrosh oficerë të shkallëve dhe të breznive të ndryshme të cilët kanë lënë jetën e tyre në vlera të mëdha hartograike dhe gjeodezike.

Më pas vjen një brezni tjetër kuadrosh që mbaruan shkollat ushtarake brenda vendit dhe u arsimuan edhe në Univeristetin e Tiranës, si: Përparim Likaj, Maksimilian Gjika, Eduart Isufi, Stafan Shahini, Asllan Muka, Piro Dado, Bajram Muja, Asllan Bebeçi, Kostandin Premti e shumë të tjerë që mbushën kontributet teknike e kërkimore në fushat inxhinierike. Po kështu një bashkësi e tërë kuadrosh topografë nga shkollat ushtarake zunë pozicione të rëndësishme në Institut, si në Astronomi, Gjeodezi etj.

- Para krijimit të këtij ITU si ka qenë e ndërtuar veprimtaria e topografisë ushtarake, nga qendra

INSITUTIT GJEOGRAFIK USHTARAK

8 marsi është dita e krijimit të Insitutit Gjeografik Ushtarak, por nuk është vetëm dita e breznive të topografëve, hartografëve dhe gjeodezëve të FA, por e gjithë kombit shqiptar, mbasi ajo është fytyrë e shëmbëllimit të sotëm e të djeshëm të historisë arbërore, gjithnjë në brendësinë e kujtesës së kombit

në njësi e reparte?

Deri në këtë kohë ishte bërë një punë shumë e madhe për ta rimarrë misionin, sidomos pas prishjes së marrëdhënies me ish-Bashkimin Sovjetik dhe shërbimin topografik të Ushtrisë së Kuqe. Vendi kish ngelur pa harta, të cilat u mbajtën dhe u vodhën nga pala ruse, fakt për të cilin ende nuk është thënë gjer më sot. Situata duhej kapërxyer. Kështu ishin krijuar Reparti Topofotogrammetrik, ai Gjeodezik, Hartografik dhe i depove të hartave etj. Mbi bazën e tyre u krijua ITU. Udhë e hap dhe u zhvillua ishte një arritje e madhe. Energji intelektuale u derdhën për të kryer këtë vepër të madhe. Kontributi drejtues dhe studimor i Dr. Përparim Likaj, Vait Tartari, Veiz Ostrovica, Qemal Sinanaj, Naim Domi, Bajram Muja e të tjerë është i spikatur.

- Ju jeni një ndër specilaistët më në zë të topografisë ushtarake. A mund të na rëndisësh disa nga arritjet ndër vite të IGJUSH, si dhe etapat e evolimit të tij që nga krijimi dhe deri në ditët e sotme?

Kujtuam pak më parë atë që quhet "Mision", që nuk lidhet për gryke nga politika dhe ideologjia. Është ana shkencore dhe teknike që ka themel. Nëse ka diçka që duhet t'u thuhet me lavd breznisë që shkoi dhe që ndërtoi ITU, është se ata shikuan në rrënjë "Misionin topografik dhe gjeodezik" dhe për këtë do të ngelen në histori. Breznia që erdhi e gjeti këtë udhë të hapur. Kjo duhet thënë me plot gojën. Rrallë mund të ketë ndodhur që në kushte të izolimit komunist të ndërtoheshin vepra aq të mëdha kombëtare se sa rrjeti Gjeodezik Shtetëror, se sa hartografimi në të gjithë

shkallët (1: 10 000, 1: 25 000, 1: 50 000 deri në 1: 1000 000) vepra të vlerësuar nga ana shkencore dhe teknike gjer në ditë të sotme. Ka qenë një energji e jashtëzakonshme. Pa këtë bazë nuk do të kishin arritur kulme dhe nuk do të kish pasur një Institut Gjeografik Ushtarak, i cili të përballlej me kërkesa të reja të zhvillimeve postkomuniste. Është një periudhë e gjatë, e trazuar, me zigzage të cilat kulmuan në vitin 1997 kur ky institut u gjend në prag të shfarosjes dhe djegies makabre. Por u arrit që të shpëtohej, ndërkaq ishte në pikëpyetje e ardhmja e tij. Në këto kushte u riformësua Instituti Gjeografik Ushtarak me një fytyrë moderne dhe që shumë shpejt u radhit me dinjitet përkrah instituteve homologe të vende të NATO-s. Bazë gjithnjë ka qenë tradita e krijuar ndër dekada.

- Realizimi i hartave dhe i studimeve në funksion të këtyre angazhimeve kombëtare është një ndër detyrat kryesore të Institutit. Çfarë pune është bërë ndër vite në këtë aspekt dhe ç'problematika mund të ketë të pazgjidhura?

Nuk është e lehtë që të jesh në hullinë e informacioneve moderne si dhe të teknologjive. Mos harroni se Shqipëria të gjithë projektet zhvillimore të saj i ka bërë dhe po i bën në bazë të hartografimit dhe të gjeodezisë themelore që ka kryer ky institut. Nuk është pak të shndërrosh sitemin gjeodezik, të kalosh në harta të standardeve të NATO-s, në zhvillimin e Sistemit të Pozicionimit Global, të bashkëpunimit me institucione të huaja. Këto janë vlera që janë pranuar nga partnerët ndërkombëtar. Ky është një realitet krenarie, sigurisht.

- Ju kolonel, shpesh përmendni termin "djepi hartografik" ku e keni fjalën?

Na kujtohet një djep i amëshuar, që përkundet. Dhe vjen pastaj një çast tjetër, kur gjithsecili prej nesh gjen inspirimin e vetvetishëm të jetës dhe të përvijës, duke trokitur dhe kërkuar rrënjët, në kujtesën e udhës rritëse të profesionit, të institucioneve të cilat e kanë gjalluar jetën me gjurmë të pashlyera. Të zgjohet kujtesa me një hartë Shqipërie në dorë, krahë çeljes së luleve, me një hartë të përtërirë, të ardhur prej mbijetesës kombëtare, gjer në ditë të sotme të synimeve thelbore rropiane. Me këtë hartë shoh portretin e mbijetesës, ndihmesat e breznive, për të vizatuar e pikturuar tiparet e këtij dheu, shtrirjen historike, në projekcionet e padrejtësive, kufijtë e prerë prej tragjedisë dhe me ndryshimet që u bënë përmbi këtë portret. Ja ky është djepi hartografik që na përkund. Në 8 mars vjen dhe dita e krijimit të Insitutit Gjeografik Ushtarak, që nuk është vetëm dita e breznive të topografëve, hartografëve dhe gjeodezëve të Forcave të Armatosura, por të gjithë kombit shqiptar, mbasi ajo është fytyrë e shëmbëllimit të sotëm e të djeshëm të historisë Arbërore, gjithnjë në brendësinë e kujtesës së kombit.

- Folët për mision hartografik kombëtar. A është cenuar ndonjëherë?

Është festë dhe në raste të tilla nuk flitet për plagët dhe dhimbjet. Një dorë tinzare, një politikë që për një kohë e ka "pushtuar" misionin dhe e ka komanduar atë, a nuk është një frymë antikombëtare, a nuk është shmangie e misionit e këtij Instituti si Marrëveshja e Detit me Greqinë, e cila pati në thelb të saj krimin politik që bëri qeveria e asaj kohe, ndaj profesionalizmit. Politika e detyroi Institutin që të mos e thotë fjalën studimore në një hartë të Detit Arbëror në atë pakt të turpshëm të rrëzuar, tanimë. Instituti është aset i madh kombëtar.

- Çfarë mesazhi u përcjell sot Profesor Pashaj drejtuesve, specialistëve dhe punonjësve të IGJUSH?

Tani instituti quhet: Instituti Gjeografik dhe Infrastrukturës Ushtarake, për shkak të ndryshimeve dhe reformave që po bëhen. Mesazhi nuk do shumë lulla dhe fishekzjarre. Kërkohet një realitet dhe angazhim tërësor në zhvillimet e sotme në rajon dhe më gjerë, në situatat gjeopolitike që mund të vijnë, ku gjeografia loz rolin e saj të madhnueshëm vetëm atëherë kur roja hartografike kombëtare është në krye të orjentimeve zhvillimore të reformave të sotme jo vetëm në FA, por edhe për gjithë vendin. Udhë e mirë e përtëritjes së hartave 1: 25 000 sipas standardeve të NATO-s dhe një projekt-detar me Norvegjinë, rrëfen se këto koordinata orintuese janë inspiruese. Drejtori aktual, nënkolonel Çani, e ka këtë shqetësim dhe orientim për ardhmërinë.

Gjuajtësi i Madh Detar P-207 "Vjosa" ka shërbyer në Forcat Detare të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 53 vjet

Historia e Gjuajtësit të Madh Detar P-207 "VJOSA"

Nga Kapiten i Rangut të Parë (Ret)
ARTUR MEÇOLLARI

Historia detare e Shqipërisë është e lashtë, ndërsa ajo e Forcës Detare e lavdishme. Por në këtë shkrim do të ndalemi në historikun e një prej anijeve më të fuqishme luftarake që Flota jonë Ushtarake Detare ka pasur në dispozitivin e saj luftarakë përgjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, madje deri në dekadën e parë të këtij shekulli. Fjala është për Gjuajtësin e Madh Detar (GJDM) P-207 "Vjosa". Ky gjuajtës është prodhuar në ish-Bashkimin Sovjetik në vitin 1954. Ai është i projektit "22 BIS" dhe klasifikuar nga NATO i klasit "Kronshadt". Është një nga gjashtë gjuajtësat e marrë nga ish-Bashkimi Sovjetik në vitin 1958, dy prej të cilëve shkuan përsëri në ish-Bashkimin Sovjetik dhe nuk u kthyen më. Pra, në armatimin e Forcës Detare kanë qenë katër gjuajtës të mëdhenj të projektit "122 BIS" dhe konkretisht: "Vjosa", "Semani", "Buna" dhe "Drini". Në bordin e katër gjuajtësave Flamuri i Flotës Luftarake të Shqipërisë u ngrit më 15 mars 1958 në Portin e Durrësit. Katër gjuajtësat hynë për herë të parë në Ishullin e Sazanit më 26 mars 1958.

Gjuajtësi i madh detar P-207 "Vjosa" ka shërbyer në Forcat Detare të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 53 vjet dhe katër vjetë në ish BS. Gjatë 53 viteve të shërbimit GJMD P-207 është komanduar nga 15 komandant, oficerë të Forcave Detare. Në këtë gjuajtës kanë shërbyer breza të tërë oficerësh, nënoficerësh dhe detarësh, të cilët me përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre kanë përmbushur misionin e tij dhe i kanë shërbyer Republikës së Shqipërisë.

Gjuajtësi i Madh Detar P-207 "Vjosa" është klasifikuar nga prodhuesi si anije e specializuar për luftën kundër nëndetësve. GJMD "Vjosa" për 53 vjetë me Flamurin Kombëtar të valvitur në majën e Direktut ka shërbyer në rajonin e Gjirit të Vlorës. Nga viti 1958 deri në vitin 1987 GJMD ka pasur si vendbazim Bazën Detare të Sazanit dhe nga viti 1987 deri në vitin 2011 Bazën Detare të Pashalimanit.

GJMD ka pasur tre sisteme të luftës kundër nëndetësve, si dhe fuqi të lartë zjarri të artilerisë (85 mm, 37 mm dhe 12,7 mm) për mbrojtjen kundërajrore. Gjatë karrierës së tij ai ka marrë pjesë në disa operacione kundërnëndetëse, operacione të kontrollit të kufirit detar dhe kapjeve detare, operacione SAR,



operacione të tregimit të forcës etj. Mbas vitit 1992 ai ka marrë pjesë në të gjitha stërvitjet që Forcat Detare kanë kryer në Shqipëri në kuadër të NATO/PPF, iniciativave rajonale apo me partnerët tanë detar. Stërvitja e fundit që GJMD P-207 ka marrë pjesë është Stërvitja ADRION LIVEX 2009 e zhvilluar në Shqipëri. Gjuajtësi i Madh Detar P-207 ka mbajtur emrin "Vjosa" qysh nga viti 1958. Nga viti 1958 deri në vitin 1992 numri i bordit të tij është ndërruar çdo vit. Në vitin 1992 ai mori numrin e bordit F-322, si një anije me karakteristika të luftës kundërnëndetëse. Në vitin 1997 Gjuajtësi i madh detar F-322 u riklasifikua si anije e patrullimit detar dhe numri i bordit ndryshoi në P-207.

Gjuajtësi i madh detar P-207 "Vjosa" u nxorr nga armatimi i Forcave tona të Armatosura me urdhër të kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Nr. 80, datë 14.09.2011. Ai ishte i fundit nga katër gjuajtësat e mëdhenj të projektit "122 BIS". GJMD "Buna" është mbytur gjatë trazirave tragjike të vitit 1997 në Gjirin e Vlorës, "Semani" është nxjerrë nga armatimi në vitin 2002 dhe "Drini" në vitin 2002. Aktualisht GJMD P-207 "Vjosa" gjendet në Bazën Detare të Pashalimanit dhe është i vetmi gjuajtës i këtij lloji i mbetur.

Kujtime dhe impresione që mbeten të pshlyera në shpirtë dhe në kujtesë

Kam shërbyer në bordin e GJMD F-322 për gati 10 vjet, nga viti 1989 deri në vitin 1999. Mbas përfundimit të Akademisë së Detarisë në Vlorë dhe diplomimit oficer në vitin 1989 u emërova në Bazën Detare të Pashalimanit, pikërisht në GJMD "Vjosa", i cili ishte dislokuar në këtë bazë që nga viti 1987. Babai im, si një ushtarake

i vjetër i Flotës Detare, ka shërbyer për gati tetë vjet në GJMD simotër "Semani", kur ai gjendej i dislokuar në Bazën e Sazanit, kohë në të cilën edhe familja ime jetonte në Sazan. Pikërisht këtu, në këtë ishull kam lindur dhe unë, këtu mora ndjesitë e para që të fal deti, që të falnin anijet luftarake të

Komandantët e Gjuajtësit të Madh Detar "VJOSA"	
1.	Diktim Halili
2.	Rustem Sharkaj
3.	Mihal Kallajeri
4.	Hajri Kreshpa
5.	Safet Gjondedaj
6.	Kujtim Braçe
7.	Kujtim Bregu
8.	Fatmir Kalemi
9.	Artur Meçollari
10.	Faslli Boraku
11.	Festim Derraj
12.	Everest Haxhiu
13.	Fatmir Likskëndaj
14.	Enton Gogu
15.	Fajon Tozaj

ankoruara aso kohe në bazën e vogël të Sazanit. Këtu më lindi dhe u ngjiz dëshira ime për të vijuar në rrugën e babait tim... Fillimisht si komandant i Organit Luftarak 2-3 (armatimi i artilerisë dhe luftës kundërnëndetëse), më pas si zëvendëskomandant dhe në korrik 1993 u emërova komandant i

GJMD F-322 "Vjosa". Në përgjithësi të gjitha periudhat e shërbimit në GJMD F-322 "Vjosa" kanë qenë impresionuese, por nga më të veçantat ka qënë ajo kur kryeja detyrën e komandantit. Kushdo oficer marine që ka qënë komandant anije, e njeh privilegjin dhe përgjegjësinë e kësaj detyre. Për



Të dhënat e Gjuajtësit të Madh Detar P-207 "VJOSA"

Numri i Bordit	P-207	
Emri	VJOSA	
Klasi	122 BIS ose KRONSHTADT (sipas NATO-s)	
Tipi i mjetit hundues	Gjuajtës Detar i Madh	
Viti i prodhimit	1954	
Vendi i prodhimit	ish-Bashkimi Sovjetik	
Koha e hyrjes në shërbim në Shqipëri	1958	
Koha e daljes nga shërbimi	2011	
Vendqëndrimi	Pashaliman	
Tonazhi i plotë	350 Ton	
Përmasat	<i>Gjatësia</i>	52,24 m
	<i>Gjerësia</i>	6,48 m
	<i>Peshkimi</i>	2,35 m
Motorrat kryesor	<i>Tipi</i>	3X9DM
	<i>Fuqia</i>	3X1100 kf
Motorrat ndihmues	<i>Tipi</i>	1 x 7D6 dhe 1 x 4Ç
	<i>Fuqia</i>	1x150 kf dhe 1x40 kf
Shpejtësia	<i>Mesatare</i>	11 Nyje
	<i>Maksimale</i>	18 Nyje
Autonomia	<i>Në Milie</i>	3100
	<i>Në Orë</i>	7 ditë (168 orë)
Efektivi	<i>Oficerë</i>	4
	<i>Nënoficerë</i>	4
	<i>Detarë</i>	30
Armatimi		1x85 mm një grykësh
		2x 37mm një grykësh
		3x 12,7mm dy grykësh
		Dy bombalëshues të kicit
		Dy bomba dhës reaktiv
Radar		Dy bomba dhës anësor
		FORUNO



Gjatë periudhës si komandant i GJMD kam pasur mundësinë të marrë pjesë në shumë operacione luftarake, operacione edhe me ndjeshmëri të lartë politike dhe diplomatike. Një nga misionet më të zakonshme të GJMD në atë periudhë ka qënë zbatimi i embargos ndaj ish-Jugosllavisë në ujërat territoriale të Shqipërisë dhe lufta kundër kontrabandës. Po ashtu pjesëmarrja në stervitjet me partnerët amerikanë dhe turq në stervitjet SAREX dhe MAREX në vitet 1995 dhe 1996 kanë qënë një eksperiencë e jashtëzakonshme. Këto stervitje ishin stervitjet e para të përbashkëta të Forcës Detare me partnerët e Shqipërisë në NATO. Momentet e sukseseve dhe kënaqësisë në përbashkëtimin e detarëve si komandant i GJMD F-322 "Vjosa" kanë qënë të përditëshme, ashtu sikurse ka pasur edhe momente të vështira. Një moment i vështirë gjatë karrierës time si komandant i GJMD F-322 "Vjosa" ka qënë edhe i datës 16 shtator 1994, gjatë një incidenti ushtarak, kur lufta dhe paqja ishin shumë pranë. Në atë kohë GJMD kishte marrë detyrë të patrullonte në Kanalin e Korfuzit, ndërsa situata midis dy vendeve ishte tejet e tensionuar. Një manovër e papërshtatëshme dhe provokative e një anije patrulluese greke dhe hyrja

shkak të misionit, mjedisit ku operon dhe sidomos pavarësisë operacionale, komandanti i anijes ka pushtet gati të pakufizuar gjatë përbushjes së misionit. Po ashtu, për shkak se ushtron detyrën në territor të lëvizëshëm, i cili valëvit flamurin kombëtar, përgjegjësia e komandantit të anijes është shumë e lartë. Janë pikërisht këto, por edhe mjaft detaje të tjera, që më bëjnë që edhe sot kur kujtoj kohën kur kam shërbyer si komandant të kësaj anije ta përvcaktoj këtë periudhë si më impresionuesen në karrierën time. Karakteristikat e kësaj anije janë një sfidë për drejtimin e saj. Misioni kompleks dhe nevoja për profesionalizëm nga i gjithë ekuipazhi ishin një nga sfidat më të mëdha. GJMD "Vjosa" ka edukuar breza të tërë oficerësh, nënoficerësh dhe detarësh, ashtu sikurse edhe ata i kanë shërbyer atij dhe atdheut me përkushtim, profesionalizëm dhe atëdhedashuri.

Janë të shumtë oficerët dhe detarët që kanë lënë gjurmë në memorien time, por në pamundësi për të rreshtuar shumë e shumë prej tyre, po përmend vetëm disa. Po e nis me komandantin tim të parë të GJMD "Vjosa", kapiten i rangut të dytë Kujtim Bregu, po kështu ka qënë një privilegj të mësoja nga kapiten i rangut të dytë Festim Gjika, kapiten i rangut të tretë Ilmi Sulçe, Fatmit Kalemi, Anastas Goga, Andrea Truja etj, një brez oficerësh të talentuar, profesionist dhe me kulturë të gjërë. Karriera ime si komandant i GJMD "Vjosa" nuk do të ishte e suksesshme pa kontributin dhe bashkëpunimin e vartësve të mi, që sot janë bërë oficerë drejtues dinjitozë në Forcën Detare si: Adnand Agastra, Festim Derraj, Dashmir Çaushaj Edmond Qarri, si dhe një numër nënoficerësh si: Bejkush Çelaj, Selman Leka, Edmond Kulluri, Barjam Kreka etj.

e saj në detin territorial të Shqipërisë në Gjirin e Sarandës më detyroi të përgjigjesha po me manovër. Situata u përkeqësua edhe më shumë kur në mbështetje të dy anijeve erdhën nga dy katrasilurues, si nga Baza e Sarandës edhe nga Baza e Korfuzit. Kjo situatë, e cila ishte tejet e tensionuar dhe nën kërcënimin e përdorimit të armëve zgjati për rreth 30 minuta, derisa anijet u rreshtuan në detet territoriale respektive. Sot, mbas më se njëzetë vjetësh, kjo histori mund të përsëritet, por jo me të njëjtët aktorë. Forcat Detare Shqiptare dhe ato Greke janë pjesë e së njëjtës Aleancë dhe bashkëpunimi i tyre për çështje të sigurisë rajonale detare janë në nivelin më të lartë.

Ngritja e muzeut detar, kontribut për evakuimin e historisë dhe zhvillimin e turizmit

Për fat të mirë, Gjuajtësi i Madh Detar P-207 "Vjosa" dhe disa anije të tjera të dala përgjatë dy dekadave të fundit nga formacioni luftarak i Forcës Detare gjenden ende në ruajtje nga strukturat përkatëse të kësaj Force. Ndër to mund të përmendim një nëndetëse, katërsilurues, anije polumbare, gjuajtës i vogël detar, anija silurkapëse etj. Historia detare e Shqipërisë është e lashtë, ndërsa ajo e Forcës Detare,

ndonëse jo shumë e gjatë, por mund të themi me plot gojën është e lavdishme. Evidentimi i kësaj tradite dhe historie nëpërmjet një kompleksi muzeal, në Bazën e Pashalimanit, ku ndërthuret historia e vjetër dhe ajo moderne e detarisë shqiptare, ka qënë një ide e hedhur ndoshta më herët, por që në vitin 2007 kujtoj se është diskutuar më shumë. Për fat të keq kjo ide ka mbetur e pakonkretizuar dhe sot e kasaj dite nuk është bërë e mundur. Një muze i

traditës detare, ashtu si shumë vende me tradita detare e kanë, do të ishte një kontribut i veçantë për evokimin e historisë kombëtare, si dhe zhvillimin e turizmit në rajonin e jirit të Vlorës. Sado i kushtueshëm të jetë ky projekt (besoj se nuk duhet jetë aspak i tillë) kjo do të ishte një tjetër vlerë që do t'i shtohet pasurisë dhe krenarisë sonë kombëtare. Ne detarët, të vjetër dhe të rinj, shpesojmë në këtë projekt. Shpresa vdes e fundit.



Një foto e rrallë që ia shton vlerat historisë së GJMD "Vjosa"

Në këtë foto është e Gjuajtësi i Madh Detar P-207 "Vjosa" gjatë lundrimit me 40 konkurrese për Miss Albania 2007, konkurs i organizuar nga regjizorja Vera Grabocka. Foto është realizuar në Shën Vasil (Gjiri i Vlorës) nga Kapiteni Rangut të Dytë Artur Meçollari, aso kohe komandant i Flotiljes Detare Jugore, më datë 16 korrik 2007. Kjo foto është realizuar nga bordi i Motovedetës RB-224. Në bordin e GJMD gjenden 40 konkurrese për Miss Albania 2007 të shoqëruara nga 20 oficerë të Forcave Detare. Komandanti GJMD P-207 "Vjosa" ishte lejt-nant Fatmir Likskëndaj.

Jeta e rreshterit Xhon Thompson u shkurtua në një fushë-betejë të largët, mijëra milje larg nga Anglia Qendrore, por kujtimi i tij jetoi gjatë si në Angli ashtu dhe në Shqipëri, mes familjes Thompson dhe familjes Çala

Enigma e një unaze që zgjoi aq shumë mirënjohjeje njerëzore

MUHARREM DARDHA

Një histori e rrallë

Në fakt kjo është historia e një njeriu që nuk harroi kurrë amanetin e të atit. Jaho Çala, aty nga viti 1960, teksa punonte në zonën përreth maleve të Bizës, në kufi me krahinën e Martaneshit, kishte gjetur një unazë. Ajo që e bëri të mendohej atëherë atë burrë nuk ishte vetëm fakti se unaza ishte 24 karad flori, por diçka tjetër më e veçantë: në rrethin e saj ishin gdhendur dy emra: "Joyce & John". Dy emra krejtësisht të panjohur dhe fare të papërdorshëm asokohe në Shqipëri. Me siguri duhet të jenë amerikan apo anglez, kishte menduar ai, aq më tepër që zona ku e gjeti atë unazë, në vitet e Luftës II Botërore ishte shkelur nga emisar britanik, por aty ishin rrëzuar edhe avionë të Flotës Ajrore Britanike...Por të gjitha këto ai nuk mund t'i bënte publike. Ishte koha kur regjimi komunist i Tiranës i kishte shpallur armiq dy aleatët tanë më të mëdhenj të asaj lufte çlirimtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglinë. Jo vetëm kaq, por Jaho Çala dhe familja e tij, si një familje që vinte nga shtresa e pasur e qytetit të Elbasanit ishte internuar në fshatrat e Sulovës...Ndaj dhe ai gjeti rrugën e heshtjes, duke e ruajtur si një gjë të shenjtë këtë unazë të rrallë. Ditën që martoi djalin e tij, Xhemilin, ia dha duke i thënë: "Po ta lë ty këtë unazë, ruaje si një gjë të rrallë, por do të më premtosh që kur të vdes do të bësh çmos ta kthesh tek familja e atij që i takon, siç është shkruar këtu "Johan & Joyce"...Dhe Xhemil Çala nuk e harroi kurrë amanetin e babait derisa enigma e kësaj historie mori dritë...

Zbulimi i mbetjeve të avionit "Halifax" sipas rrëfimit të z. Gerd Kaceli

Gerd Kaceli, asistent ushtarak në Ambasadën Britanike në Tiranë është një ndër personat që na hedh mjaft dritë për këtë histori mbi 70 vjeçare. Ai thotë se, kjo është historia sa e trishtë aq edhe e rrallë e një aviatori britanik, i sapomartuar, që mbeti i vvarë së bashku me një pilot tjetër nga rrëzimi i avionit të tyre në tetorin e largët të vitit 1944 në malet e Bizës së Martaneshit, e cila lidhet njëkohësisht dhe pazgjidhshmërisht me unazën e tij të martesës që u gjet me pas nga shqiptari Jaho Çala dhe me amanetin e tij lënë të birit për të gjetur me çdo kusht të zotit e kësaj unaze...Më shumë se një vit më parë, vijon rrëfimin e tij zoti Kaceli, një ish-minator, tashmë mbledhës i bimëve mjekësore, i quajtur Allaman

Crew	Location
F/O Edwin John Stubley RAFVR - Pilot	
F/Sgt John Thompson RAF - Flight Engineer - died	
F/Sgt Ernest Logan Brown RAFVR - Navigator - died	
F/Sgt Austin Donnelly RAFVR - Air Bomber - died	
gt Alfred Coote RAFVR	

Unaza me emrat "Joyce & John"

Kunxhiu, i dërgoi një notë Ambasadës Britanike në Tiranë mbi një zbulim të mundshëm të mbetjeve të një avionit britanik të Luftës së Dytë Botërore diku në zonën e Bizës. Pas konsultimeve në Ambasadë u vendos të pritej dislokimi i përvitshëm i Marinsave Britanikë në zonën e Bizës për stërvitjen e tyre "Albanian Lion" për të parë mundësinë e dërgimit të një grupi ekspertësh. Kur Ambasada vlerësoi se mundësitë ishin dhe Marinsat Mbretërorë kishin nisur stërvitjen në rajonin e Bizës, vijon z. Kaceli, kontaktuam me personin, i cili zbuloi mbetjet e avionit, z. Kunxhiu. Ajo që ne nuk dinim ishte se zoti Kunxhiu kishte kontaktuar edhe Ambasadën Amerikane, e cila ishte në kërkim të një prej avionëve të saj të humbur në atë luftë, dhe ekspedita e parë me ekspertë amerikanë do niste vetëm pas 2 ditësh. Pas kësaj u bë e mundur që Marinsat Mbretërorë të caktojnë një ekip prej 4 vetësh për t'iu bashkëngjitur ekipit amerikan.

Z. Christopher Casey, mjeku i Ambasadës Amerikane, udhëhoqi ekipin e përbashkët me Marinsat Britanikë nën drejtimin e zotit Kunxhiu deri në vendin e rrëzimit të avionit. Më vonë ai punoi intensivisht për rastin e mbetjeve të "Halifaxit" të gjetur në Bizë. Ekipi mori fotografitë e para cilësore të mbetjeve përfshi numrat serialë dhe realizoi një raport të plotë mbi mbetjet dhe vendin e rrëzimit. Pas hulumtimeve të para teknike u krijua bindja që avioni në fjalë ishte një "Halifax" britanikë, por si përfaqësuesit britanikë, ashtu edhe

përfaqësuesit amerikanë e patën ende të vështirë identifikimin e plotë të avionit. Rastësisht, çon më tej rrëfimin e tij z. Kaceli, në një prej e-maileve midis meje dhe Krisit unë nxora historinë e Unazës. Fillimisht nuk kishte ndonjë qëllim të caktuar. Atë kohë unë nuk dija asgjë se ku ishte gjetur unaza. Vetëm së fundmi erdhi një informacion se unaza me shumë gjasa ishte gjetur në Bizë.

Unaza

Më shumë se 2 vjet më parë, atashu ushtarak britanik, n/kolonel Phil Osment, i cili mbulonte Shqipërinë, por që ishte rezidentë në Shkup, mësoi mbi një unazë e cila i përkiste një aviatori të huaj të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndoshta britanik. Unaza ishte gjetur në vendin e rrëzimit të avionit shumë vite më parë. Atë kohë Ambasada Britanike në Tiranë nuk kishte një Asistent Ushtarak dhe kryesisht çështjet ushtarake mbulohehin nga Asistentja e Kosovës dhe Zyra e Atasheut në Shkup. Për këtë çështje, n/kolonel Phil Osment dërgoi një e-mail në Londër, me anë të të cilit kërkonte asistencë, me këtë tekst:

"Disa kohë më parë ju me mirësi më ofruat asistencë për të më hedhur dritë mbi familjen e një aviatori të vvarë në Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri. Ju më thatë që keni pasur një kontakt, një historian të njohur që kishte shumë njohuri mbi fluturimet britanike të asaj kohe në Ballkan. Unë zotëroj një informacion i cili do të mund të na ndihmojë në lidhje me një unazë të gjetur. Besojmë se avioni ishte një bombardues dhe mund të ketë qenë i

“

Jaho Çala dhe familja e tij, si një familje që vinte nga shtresa e pasur e qytetit të Elbasanit ishte internuar në fshatrat e Sulovës...Ndaj dhe ai gjeti rrugën e heshtjes, duke e ruajtur si një gjë të shenjtë këtë unazë të rrallë. Ditën që martoi djalin e tij, Xhemilin, ia dha duke i thënë: "Po ta lë ty këtë unazë, ruaje si një gjë të rrallë, por do të më premtosh që kur të vdes do të bësh çmos ta kthesh tek familja e atij që i takon, siç është shkruar këtu "Johan & Joyce"...Dhe Xhemil Çala nuk e harroi kurrë amanetin e babait derisa enigma e kësaj historie mori dritë...



nënkolonel Phil Osment, nuk mundi të shkojë më tutje.

Identifikimi i avionit "Halifax" dhe kush ishin John dhe Joyce?

Siç e permenda, vijon më tej rrëfimin e tij Gerd Kaceli, Chris Casey, mjeku i Ambasadës Amerikane në Tiranë, merr infomacionin prej nesh mbi unazën. Një telefonatë me asistenten tonë në Kosovë hedh dritë mbi faktin që unaza mund të jetë gjetur diku pranë Bizës. Natyrisht, e paktë të thuhet që kjo shkaktoi entuziazëm. Ndërkohë, filuam të hulumtojmë të gjitha të dhënat e disponueshme mbi rëniet e avionëve britanikë në Shqipëri. Ka një detaj interesant që lidhet me operacionet dhe të rëniet e asaj kohe. Emrat e ekuipazheve të cilët nuk ktheheshin nga misionet dhe për të cilët nuk konfirmohej kurrë zyrtarisht fati, regjistroheshin në memorialët e vendeve nga të cilat niseshin ekipet, ose aty ku kishin shtabet përkatëse. Në memorialin e të rënëve britanikë në Tiranë janë vetëm emrat e atyre për të cilat ka prova zyrtare që kanë humbur jetën në territorin shqiptar. Historia e unazës me emrat e gdhendur, si dhe fakti se ajo ndoshta ishte gjetur në Bizë e ngushtuan kërkimin. Kaluam në sitë të gjithë të rënë britanikë me emrin John në Shqipëri dhe askush nuk kishte detaje familjare përkatëse për një grua të quajtur "Joyce". Aktualisht janë tre të rënë britanik të konfirmuar në Shqipëri me emrin John (emrat gjenden në memorialin në Tiranë) dhe 2 prej tyre kanë qenë pilotë, por nga verifikimet e bëra asnjëri prej tyre nuk rezultoi të ishte njeriu i unazës.

Përgjatë hulumtimit të dokumentacionit ndeshëm edhe një një dokument online botuar nga një i afërm i një piloti britanik të rrezuar në Shqipëri, i quajtur Jon Cole. Fillimisht menduam se ky ishte avioni që kërkoni, sepse raportohet si një avion në mision për furnizime në Bizë, por faktet flasin se ai ishte rrëzuar në Dukat të Vlorës. Megjithatë fati e solli që në fund të dokumentit personi në fjalë të kishte përfshirë edhe një link si referencë, i cili e ndihmoi



Në kërkim të avionit të rrëzuar 70 vjet më parë

kërkimin. Bëhej fjalë për një listë të plotë të avionëve britanikë të rënë në Luftën e Dytë Botërore publikuar nga Muzeu i Harringtonit. Në faqen 417 të dokumentit, një Halifax (Mk IIP244) i Skuadronit 148 jepet si i zhdukur, pa koordinata dhe pa ngjarje, ndërsa ishte nisur në mision furnizimi për Operacionet Speciale në Shqipëri, me datë 20 tetor 1944. Nuk ka të dhëna të tjera përveç faktit se memorialet me emrat e ekuipazhit janë në Maltë. Natyrisht të pakonfirmuar si të rënë në Shqipëri. Dhe konkretisht:

F/O Edwin John Stuble RAFVR - Pilot – died,
F/Sgt John Thompson RAF - Flight Engineer – died,
F/Sgt Ernest Logan Brown RAFVR - Navigator – died,
F/Sgt Austin Donnelly RAFVR - Air Bomber – died,
Sgt Alfred Coote RAFVR - Wireless Op / Gunner – died,
Sgt Richard Charles Knee RAFVR - Gunner/Dispatcher – died,
Sgt Charles Mabbs RAFVR - Gunner – died.

Pra, këtu del edhe emri i John Thompson. Përgjatë kërkimit mbi këtë fluturim doli se rreshteri/tekniku i fluturimit John Thompson rezultonte të ishte i martuar me J. Në këtë kohë Chris Casey shkroi: "Rishikimi i listave të ekuipazhit nga dokumenti i Muzeut Harrington, tregoi se fluturimi JP244FS (Halifax) kishte dy ushtarakë britanikë me emrin John në bord. Piloti i cili ishte i pamartuar nuk u mor në konsideratë për ngjarjen, por tekniku i fluturimit rezultonte të kishte lënë pas një vejtshë me inicialin e emrit J". Chris u mor gjatë me kërkimin në gjendjen civile. Gjetja e regjistrat të tij të lindjes dhe gjithashtu dokumente të tjera nxorën edhe mbiemrin e vajzërisë së bashkëshortes së tij "Mosley". Në certifikatën e saj të lindjes ajo rezultoi si "Mozley", me shumë gjasa një gabim i një shkronje nga autoritetet e kohës. Rishikimi i të dhënave në zonën e Hackney nxori një grua me emrin Ruby Joyce Mosley, e martuar me John Thompson në korrik të 1944 në Hackney. Ajo kishte lindur në vitin 1923 në Swindon, Wiltshire dhe vdekur në

nëntor 1993 në Milton Keynes. Ajo me sa duket u martua përsëri në 1947 dhe jetonte me bashkëshortin e dytë (në bazë të regjistrimeve të votimit për shumë vjet) në 32 Englefield Rd. Mesa duket nuk kishte fëmijë as nga martesat e parë dhe as nga e dyta"

Këto gjetje finalizohen përafërsisht me 29 tetor 2014, ekzaktësisht 70 vjet pas rrëzimit të avionit. Me sa duket 70 vjet është edhe jetëgjatësia e znj. Joyce Thompson, lindur në 1923 dhe vdekur në vitin 1993. Pas këtyre gjetjeve, Ambasada Britanike në Tiranë kontaktoi ish-atasheun, n/kolonel Phil Osment, i cili ofroi adresën elektronike të z. Muhamet Alicka. Zoti Alicka u përgjigj shpejt dhe kontaktoi mbajtësin e unazës z. Xhemil Çala, i cili u paraqit në Ambasadë rreth nëntorit të vitit 2014 duke sjellë me vete edhe unazën e aviatorit britanik. Ai shpjegoi atë që dinte nga babai i tij për gjetjen e unazës. Babai i tij kishte qenë një marangoz dhe mbledhte dru në zonën e Bizës të Martaneshit. Rreth viteve 60' ai gjeti unazën, ende në mbetjet e

gishtit të Johnit dhe e ruajti atë. Kur i biri, Xhemili, u martua ai i dha atij unazën duke i thënë: "Po ta lë ty këtë unazë, ruaje si një gjë të rrallë, por do të më premtosh që kur të vdes do të bësh çmos ta kthesh tek familja e atij që i takon, siç është shkruar këtu "Johan & Joyce".

Në të njëjtën kohë, përfundon rrëfimin e tij z. Gerd Kaceli, u kontaktua një gazetë lokale në Britani, e cila publikoi disa nga gjetjet tona. Artikulli funksionoi dhe pranë redaksisë u paraqitën disa nga të afërmit e Johnit. Tre motra të tij janë akoma në jetë, por sidomos motra e madhe Dorothy, 92 vjeçare, përjetoj një lumturim të jashtëzakonshëm. Unaza, që mbante të fiksuar një histori dashurie në emrat e gdhendur në përjetësi, hodhi dritë mbi rrëzimin e "Halifax" dhe i dha fund një dileme familjare mbi 70 vjeçare, duke zgjuar njëherazi edhe kaq shumë mirënjohjeje njerëzore.

Ceremonia në Ministrinë e Mbrojtjes

Si një epilog i bukur i gjithë kësaj historie të rrallë ishte ceremonia që u zhvillua para pak ditësh në Ministrinë e Mbrojtjes. Ishtë vërtetë një ceremoni sa e veçantë, aq edhe mbesëlënëse. Në qendër të saj ishte akti i dorëzimit të unazës së pilotit anglez, rreshterit Xhon Thompson, rënë në krye të detyrës gjatë Luftës së Dytë Botërore, në tetor të vitit 1944, në Kaptinë të Martaneshit. Pas ekzekutimit të Himnit Kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar dhe Himnit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë, z. Muhamet Alicka, personi që kontaktoi me Ambasadën Britanike, tregoi shkurtimisht historinë e kësaj unaze. Shumë emocione përcolli në fjalën e tij nipi i pilotit të vrarë britanik, z. Alan Webster, si dhe ambasadori britanik në Tiranë, z. Nicholas Can-

non. Ndërsa ministrja e Mbrojtjes Kodheli, lidhur me këtë histori të trishtë u shpreh se, rreshteri britanik Xhon Thompson, në një ditë të ftohtë të tetorit 1944 humbi jetën kur avioni i tij "Halifax" u përplas në malet shqiptare pas furnizimit që u kishte bërë njëseve tona në luftë me okupatorin nazist. Djaloshi 23 vjeçar dha jetën për një kauzë të përbashkët dhe ne sot po kujtojmë të gjithë ata që bënë sakrificën finale për vendet tona, po kujtojmë dëshmorët e rënë që nuk u kthyen kurrë tek miqtë dhe familjet e tyre... Unë shpresoj që dhimbjet e familjarëve të këtyre heronjve të rënë në fushën e betejës të lehtësohen sadopak prej faktit që ata ranë për një kauzë fisnike: çliruan miliona njerëz nga tirania mizore nazi-fashiste", u shpreh Kodheli.

Ajo vlerësoi kontributin e madh që dhanë për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazi-fashistë aleatët tanë natyralë, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku operacionet ajrore britanike, të koordinuara me misionet ushtarake atashuar pranë njëseve të rezistencës shqiptare, ishin pa dyshim çelësi i suksesit të fitores finale. Pa luftës, ata që erdhën në pushtet e injoruan kontributin e aleatëve tanë, por shqiptarët e thjeshtë i dinin fort mirë të vërtetat e luftës, i dinin fort mirë se ata britanikë që iu atashuan formacioneve luftarake shqiptare të rezistencës, ndihmuan për çlirimin e vendit. Dhe njerëz të thjeshtë si Jaho Çala për asnjë moment nuk harruan vlerat e shqiptarit të vërtetë. Rreshteri Xhon Thompson i la të dashurit e zemrës përpara kohe, jeta iu shkurtua në një fushë-betëjë të largët mijëra milje larg nga Anglia Qendrore. Por kujtimi i tij jetoi gjatë si në Angli ashtu dhe në Shqipëri, mes familjes Thompson dhe familjes Çala, është shprehur ministrja Kodheli.

Mjaft emocional ishte momenti kur, Xhemil Çala, djali i Jaho Çalës, i dorëzoi unazën motrës së pilotit të vrarë, Xhon Thompson, znj. Dorothy Webster, e cila ndonëse në një moshë kaq të thyer, kishte udhëtuar që nga Anglia për të marrë pjesë në këtë eveniment të rrallë të jetës së saj. Ndërsa ministrja Kodheli i dorëzoi znj. Webster një kuti ku ishin vendosur pjesë të avionit dhe gurë nga mali i Sinojit, ku ishte rrëzuar mbi 70 vjet më parë avioni. Po kështu ajo i akordoi "Certifikatën e Mirënjohjes" z. Jaho Çala, e cila iu dorëzua të birit, z. Xhemil Çala. Dhe së fundi, një foto e përbashkët përballë godinës së Ministrisë së Mbrojtjes, si një kujtim i bukur për të gjithë ata që ishin autorë dhe dëshmitarë të kësaj historie të rrallë.



Xhemil Çala me nipin e pilotit britanik të rënë në Shqipëri, Alan Webster



Roli i naftës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe gjeopolitike

Nënkolonel MSc. NAZMI DAKA

Në vend të hyrjes

Aktivitetet e prodhimit dhe bota moderne janë bërë të varura nga burimet e energjisë. Duke filluar nga industria e automobilave e deri në industrinë e luftës, kërkesa thelbësore e tyre është për lëndën e parë, naftën, e cila për ta është kthyer në nevojë jetike. Por bota sot nuk ofron mundësi të barabarta për çdo rajon, njeri është vendi i origjinës, ndërsa të tjerët janë të varur nga këto vende. Nafta, që nga fillimi i shekullit XX, është mjeti më “efektiv” në historinë ekonomike dhe politike. Ajo ka qenë një nga faktorët që ka formësuar dhe transformuar konfliktet ndërshtetërore, politikat ndërkombëtare, luftërat, paqen, vendet, shoqëritë dhe sistemin ndërkombëtar. Në fillim, nafta është përdorur për të ndezur zjarrin dhe për ndriçim, më vonë, ajo gjeti përdorim të gjerë në motorët me djegie të brendshme, duke i dhënë një shtysë të fuqishme zhvillimit të shoqërisë. Nafta përdoret në shumë fusha të jetës së përditshme si një material thelbësor për industrinë dhe nevojat ushtarake, duke hyrë në histori si ndryshuesja e botës. Historia e naftës ka filluar në fund të shekullit të 19-të dhe në disiplinën e tilla si: historia politike, politika ndërkombëtare dhe ekonomia politike, është një nga çështjet kryesore që trajtohet. Nafta si një nga elementet e pazëvendësueshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, është kthyer në një prej instrumenteve kryesore strategjike, që përcakton qëndrimin gjeopolitik të shteteve dhe lirshmërinë e veprimit të tyre. Së fundi, nafta, për vendet që e zotërojnë, është lajmëtarja e luftërave që zhvillohen për të treguar fuqinë, ndërsa për vendet që nuk e zotërojnë, është një nga fushat ku politika e jashtme, nëpërmjet mekanizmave të saj vendimmarrës, të arrijë të prodhojë “planifikim” dhe “politikë të jashtme” për çështje të tilla si, siguria logjistike dhe gjetja e burimeve të furnizimit me energji. Në këtë kuptim, çështja në fjalë do të shtjellohet duke u përqendruar te roli i naftës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Nafta, lënda e parë e botës moderne

Nafta është një nga materialet më të njohura për njerëzimin, që nga fillimi i historisë së tij dhe është përdorur për qëllime të ndryshme. Kjo lëndë është përdorur në fusha të ndryshme, që në kohët e lashta, pa ia ditur vlerën tregtare që mbartte. Nga ndërtuesit ajo përdorej si llaç dhe si material veshjeje, ndërsa nga ndërtuesit e anijeve si stuko, nga mjekësia si material mjekësor dhe në luftëra përdorej si armë me të cilën ngjyhej shigjeta në fund dhe përdorej për atë që njihet si zjarri grek. Dihet që gjatë luftës së vitit 1228 në Bagdad, balona qelqi të mbushura me naftë janë përdorur për të përmbushur nevojat e ushtrisë. Më vonë, me zhvillimin e teknikave të ndryshme, filloi të përdorej për ndriçim dhe ngrohje në shtëpi në jetën e përditshme, duke u kthyer kështu në një element mjaft të përhapur. Në vitin 1859, në Shtetet e



Bashkuara, koloneli Drake në Titusville hapi një pus nga i cili shpërtheu lënda, e cila do të shkaktonte një revolucion industrial. Pas shpikjes së motorit me benzinë në vitin 1905, firma gjermane “Diesel” shpiku motorin me djegie të brendshme, e cila bëri të mundur rritjen në mënyrë të papërcaktuar të vlerës së naftës.

Personat e parë që e kuptuan rëndësinë e naftës dhe zhvilluan aktivitetin në këtë fushë u bënë shumë të pasur. Perandorët e parë dhe kompanitë e themeluara prej tyre u bënë aq të pasur, sa dhe shtetet. Kompanitë e naftës, të themeluara në atë kohë, janë sot gjigantët e kapitalit dhe zotëruesit e tregut botëror të naftës. Kompanitë shumëkombëshe të naftës kanë dy objektiva të rëndësishme: së pari, gjetjen dhe zhvillimin e burimeve të naftës për përmbushjen e nevojave të tregut dhe së dyti, kontrollin e furnizimit dhe të mundësive ekzistuese, për të siguruar tregun dhe për të parandaluar konkurrencën dhe rritjen e pakontroluar të çmimeve.

Këto kompani të pajisura me një strukturë të fortë organizative, luftarake, guximi, të kompletuara nga ana teknologjike dhe me efektivitet të lartë ekonomik, janë bërë aktorë të fuqishëm si në ekonomi, edhe në politikë. Ato janë bërë faktor i rëndësishëm veprimi për vendet që kanë interesa në to, në kuadrin e interesave dhe të sigurisë kombëtare. Për shembull, reagimi diplomatik me anë të një note drejtuar Shteteve të Bashkuara për rastin e “Standard Oil”, e cila përbën kërcënim për interesat e kësaj kompanie, pati reagime politiko-diplomatike. Për këtë arsye, kompanitë shumëkombëshe të naftës nuk duhen konsideruar thjesht si kombinacione apo partnerë ekonomikë. Me pak fjalë, nafta, si burimi i lëndëve të para të botës moderne është si nga përmasat ekonomiko-tregtare, ashtu dhe nga përmasat politiko-strategjike, një element i pazëvendësueshëm i rendit të ri botëror.

Nga ana tjetër, kalimi në një formë të re të jetës shoqëro-organizative, me anë të revolucioneve “politike dhe industriale”, ka një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet konceptit të modernizimit dhe kësaj lënde të rëndësishme të lartpërmendur. Koncepti i “moder-

nitetit” të Gidensit përfshin:

-qëndrimet specifike ndaj botës, të cilat duhet të jenë të hapura ndaj ndryshjes njerëzore;

-bashkimin kompleks të pozitave ekonomike, veçanërisht në prodhimin industrial dhe ekonominë e tregut;

-koncepti i shtet-kombit së bashku me demokracinë e masës.

Për rrjedhojë, periudha e daljes në skenën botërore i kuptimit të sotëm të naftës, është periudha kur normat sociologjike dhe vlerat e revolucionit industrial u vendosën në sistem, kapitalizmi nën emrin e tregtisë botërore, nga dita në ditë, u përhap dhe u zhvillua, marrëdhëniet ekonomike kanë guxuar të përdorin “mendjen” dhe si rezultat i tyre, u arrit një hap i madh cilësor. Në fakt, kërkuesit e naftës në këtë periudhë janë njohur si njerëzit më të guximshëm, duke shkuar deri në fund të botës, për të gjetur burime të reja. Gjithashtu, në këtë pikë kemi një shembull të ri të natyrës njerëzore, me elementet themelore të “modernitetit” të Gidensit, ku siç thuhet prej tij është “intervenimi i njeriut dhe qasja për t’u formësuar e mendimit të ri botëror”.

Nga ana tjetër, procesi i zhvillimit të industrisë së naftës, në krahasim me periudhat e mëparshme, është kryer në një arenë kompozimesh komplekse, me konkurrencë dhe tregti virtuale. Nafta, si një element i domosdoshëm i shoqërisë së industrializuar, është rezultat i modernizimit të botës dhe njëkohësisht, në procesin e “modernitetit”, është ndryshuesja e marrëdhënieve ndërkombëtare, veçanërisht në fushën politike, ekonomike dhe tregtare.

Kurdët dhe turqit kanë qenë armiq të betuar prej kohësh, por zyrtarët e krahinës autonome të Kurdistanit, në veri të Irakut, kanë arritur një paketë marrëveshesh me Turqinë, për të ndërtuar gazsjellës dhe naftësjellës me vlerë prej miliarda dollarësh, me qëllim që ta nxjerrin naftën dhe gazin e tyre në Detin Mesdhe. Marrëveshjet mund të kenë pasoja të rëndësishme gjeopolitike për Lindjen e Mesme dhe mund t’i japin Kurdistanit mundësinë të eksportojë 2 milionë fuçi naftë në ditë e së paku, 10 miliardë metra kub gaz në vit përmes Turqisë. I gjithë ky përfitim ekonomik do të mund t’i sillte rajonit zhvillimin e burimeve natyrore dhe një


demarkacion të ri.

Ajo që vlen të theksohet është se, në thelbin e ideologjive, mundësia për të siguruar mbështetje dhe për të formuar aleanca në sistemin ndërkombëtar gradualisht sa vjen e zvogëlohet dhe tashmë, ato janë të përqendruara në rolin integruar të fesë së përbashkët dhe në rolin përfshirës të qytetërimit.

Kërkimet e reja pas Luftës së Ftohtë

Teza e “Përplasjes së Qytetërimeve”, e Huntingtonit, është e para që u hodh pas Luftës së Ftohtë, është teza e fundit të historisë, ku bota tani, në mënyrë sistematike, ka arritur “fundin e lumtur” dhe ka përfunduar procesin evolucionar, e mbrojtur nga Fukuyama. Pas kësaj, Huntingtoni hodhi idenë se nuk ka një “fund të lumtur” të jetës, por ka ndryshuar vetëm sistemi dhe përmasat e përplasjes dhe mbi këtë bazë, hodhi tezën e “Përplasjes së Qytetërimeve”. Huntingtoni ka mbrojtur mendimin se vendin e ndarjeve politike dhe ekonomike të periudhës së Luftës së Ftohtë do ta zënë marrëdhëniet ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve. Qytetërimet i gruponte kështu: Qytetërimi Perëndimor, konfucian, islamik, indian, sllavo-ortodoks, latino-amerikan dhe afrikan. Gjithashtu, ai thekson që në bazë të ideologjive të vendeve të ndryshme, të formohen aleanca me sistemin ndërkombëtar për të siguruar mbështetje për mundësinë e një feje të përbashkët dhe të qytetërimit të zvogëluar gradualisht.

Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, në rajonin e Ballkanit, në Kaukaz apo dhe në rajone të tjera të botës kanë dalë probleme të reja, si p.sh., problemi i mbushjes së boshllëkut gjeopolitik të krijuar dhe çfarë do të bëhet me elementët “integruar” dhe “separatistë” të rajoneve. Vendndodhjet gjeografike problematike, të identifikuar nga Huntingtoni, janë kryesisht Kaukazi, Lindja e Mesme, Amerika e Jugut dhe Afrika, të cilat sikurse duken, janë ose mbartës të rezervave të naftës, ose mundësi të





ekzistencës së saj. Në të njëjtën kohë, këto rajone janë ç'shënjuar nga Fuqitë e Mëdha, popujt e këtyre vendeve janë përzier dhe janë kthyer në arena të manipulimeve politike.

Sot, konfliktet e brendshme në rajonin e Lindjes së Mesme janë shprehje praktike e asaj që u theksua më lart dhe një arsye më tepër për ndërhyrje nga shtetet me ndikim botëror, të cilët krijojnë gjeopolitikën e tyre mbi këto konflikte. Kështu që sot, nafta dhe burimet e tjera të energjisë janë të një rëndësie të veçantë, edhe për faktin se prodhimi i tyre nga vendet e mëdha ka rënë dhe bota e sotme sa vjen dhe është më e varur nga "energja". Vendet zotëruese të saj janë në konflikt të vazhdueshëm (kam parasysh këtu dhe përvojën historike).

Praktika e politikës energjetike në marrëdhëniet ndërkombëtare

Edhe pse nafta, simbolikisht është një burim i energjisë, në shekullin tonë të zhvillimit ekonomik është një nga burimet kryesore në fushën industriale, ushtarake dhe politike, si dhe arsyeja e ekzistencës së disa problemeve ndërkombëtare që përjetohen sot ("të fshehura" apo "publike"). Në të vërtetë, industria ndërkombëtare e naftës ka zhvillimet e veta dhe është një sistem social, i cili, me vështirësi mundohet të ruajë ekuilibrin. Ky sistem, zhvillimin e kompanive energjetike, kombëtare apo ndërkombëtare, e shkrin në një dhe e kthen kështu në një rezultat të ri social-ekonomik dhe politik. Në këtë kuptim, energjia në përgjithësi dhe nafta në veçanti, duhet të konsiderohen si një dukuri ndërkombëtare, që përfshin marrëdhëniet e ndërsjella mes shteteve, organizatave, kompanive, komuniteteve dhe madje, edhe mes individëve.

Për të gjykuar mbi përmasat e ngjarjeve që mund të ndodhin dhe përfundimet e tyre, si rezultat i kërkesës së lartë për naftë, mjafton të kemi parasysh thënien e Einston Churchill në vitin 1936 në Dhomën e Përfaqësuesve, duke diskutuar interesat e Britanisë, i cili thekson se: "Një pikë naftë është më e çmuar se një pikë gjaku". Është e kuptueshme se shkak i disa luftërave deri në ditët e sotme dhe një nga elementet më të rëndësishëm që qëndron pas politikës ndërkombëtare, është dhe nafta.

Këto fjalë, krahas të qenit një nga shkaqet e Luftës së Parë Botërore, janë dhe lajmëtori i fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, rajoni kyç i zhvillimit të luftimeve ka qenë Lindja e Mesme. Lindjen e Mesme e bëjnë të veçantë jo vetëm vlerat gjeopolitike e historike që ka, por edhe mbartja në territorin e saj e naftës,

që është materiali më i vlefshëm për botën moderne. Duke vazhduar më tej, shkojmë aty ku rreh zemra e botës moderne industriale, në Gjirin Persik. Në të njëjtin rajon, pas Luftës arabo-izraelite, filloi lufta Iran-Irak, duke vazhduar më tej me konfliktin mes Azerbajxhanit dhe Armenisë, në Kaukaz dhe më pas me pushtimin e Kuvajtit nga Iraku, i cili çoi në Luftën e Gjirit. Kjo sagë, për këtë lëndë të rëndësishme, merr fund me ndërhyrjen e aleatëve dhe Shteteve të Bashkuara dhe përmbyshjen e regjimit të Sadamit.

Ajo që po ndodh sot në vendet naftëmbajtëse e më gjerë është shembull i instrumentalizimit që bën oilpolitika. Pas Kanadasë dhe Arabisë Saudite, me rezervat e provuara prej 112 miliardë fuçi, rezerva e tretë, më e madhe në botë e naftës, është Iraku. Ai është dhe një prej aktorëve më të rëndësishëm në tregun e naftës në botë. Në të njëjtën kohë, Iraku ka një vendndodhje gjeografiko-strategjike, që shtrihet nga Gadishulli Arabik deri në republikat turke, të mundshme për marrjen nën kontroll të rezervave të naftës dhe të gazit natyror.

Nafta është një burim i energjisë që ndikon në modelet politike të vendeve që e zotërojnë. Në rritjen e nacionalizmit egjiptian për zotërimin e rajonit, në periudhën osmane, një shtysë të madhe patën aktivitetet e Britanisë së Madhe. Me zbulimin e naftës në Amerikën e Jugut, pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, si: në Venezuelë, në Kolumbi, në Nikaragua, në Meksikë, ndodhi ndërrimi i pushtetit me dhunë, kështu që Fuqitë Perëndimore do të

kishin një mbështetje për të marrë koncesione të naftës nga këto vende.

Pas Luftës së Dytë Botërore, me perceptimin e kërcënimeve nga Bashkimi Sovjetik, Irani u afrua me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Si rezultat, edhe Shtetet e Bashkuara filluan të rritin efektivitetin e tyre në vend. Më parë, BRSS dhe Britania e Madhe kishin ndarë ndërmjet tyre koncesionet e naftës, njëri veriu dhe tjetri jugun e vendit. Ndikimet politike të kohës, bënë që parlamenti i Iranit, që në vitin 1947, të deklaronte të paligjshme koncesionet e BRSS në veri. Në vitin 1950, kur u diskutua çështja e shtetëzimit të naftës në Iran, kryeministri i Iranit, Musadëg, e kaloi këtë çështje në parlament. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, marrëdhëniet ndërmjet Iranit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Anglisë filluan të bëhen të tensionuara. Në fakt, një grusht shteti, në gusht të vitit 1953, rrëzoi kryeministrin Musadëg, dhe në vitin 1954, nafta e Iranit iu transferua me koncesion shoqërive perëndimore. Ashtu si në rastin e Iranit, në aspektin e instrumentalizimit të oilpolitikës, në shumë vende naftëmbajtëse në historinë politike të tyre kanë ndodhur grushte shteti dhe ndërhyrje në politikën e brendshme.

Përfundime

Në shekullin e 21-të, një nga faktorët kryesorë që përcaktojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe strategjitë e politikës së jashtme të shteteve janë burimet energjetike. Varësia ndaj energjisë është një formë e sigurisë së jashtme të vendeve. Në këtë kuptim mund të themi se: lëvizjet dhe veprimet

ndërkombëtare të vendeve kushtëzohen nga mundësitë e zotërimit të pasurive energjetike, nga sigurimi i logjistikës për energjinë dhe nga nxitja për të siguruar kontroll mbi burimet e energjisë në botë. Në të vërtetë, në shekullin e kaluar, në qendër të agjendës ka qenë rajoni i Lindjes së Mesme dhe nafta e saj, kurse sot, pa diskutim, vendin kryesor e ka zënë rajoni i Kaspikut me rezervat e naftës dhe të gazit, i cili është bërë dhe rajoni më i diskutuar. Ndërkohë që vazhdojnë përpjekjet për hegjemoni në Lindjen e Mesme, lëvizjet ndërkombëtare gjeopolitike për naftë kanë fituar një dimension të ri në rajonin e Kaspikut.

Sikurse shihet, siguria energjetike e shteteve, në kuptim të qasjes së sigurisë, si e të zotëruarit të energjisë, edhe e të zotëruarit të linjave të logjistikës, janë një lloj të rëndësishme për një vend. Strategjitë në aspektin e sigurisë, aleancat dhe madje edhe zhvillimi i teorive bazë, që formojnë shtyllën e betejave të të pasurit të energjisë, mbështetet në pasuritë nëntokësore. Kur analizojmë sot zonat problematike të hapura ndaj ndërhyrjes së huaj në botë, përballemi me faktin se ata kthehen në territor pozitiv për pasuritë nëntokësore, dhe burimet e energjisë.

Së fundmi, Kongo me minierat e uraniumit është thyer nga luftërat civile; ndërsa Iraku, bazuar në rezervat e naftës, pas luftërave, është ndarë në tri pjesë. Këta shembuj e të tjerë si këta na tregojnë se sa efektive është oilpolitika në strukturat politike, ekonomike dhe sociale të shteteve. Në kohët e

sotme, ku varësia e botës ndaj energjisë është në rritje, sidomos për naftë, është e nevojshme zhvillimi i politikave të larmishme ndërkombëtare që parashikojnë më së miri të ardhmen.

Shprehje e kësaj është koncepti i "Korridorit Jugor", i cili lindi nga nevoja e Bashkimit Evropian për shumëllojshmërinë e burimeve të furnizimit me gaz natyror, zgjerimin e bashkëpunimit energjetik me vendet fqinje dhe krijimin e një tregu energjetik të integruar dhe konkurrues.

Korridori Jugor si një rrugë moderne e mëndafshit për lidhjen e vendeve dhe popujve nga rajone të ndryshme dhe krijimin e kuadrit të duhur, të nevojshëm për inkurajimin e tregtisë, këmbimit të shumanshëm të njohurive, teknologjive dhe përvojës, do të sjellë nxitjen e zhvillimit ekonomik, mbështetjen për energjinë më të pastër, zgjerimin e integritetit të tregut dhe shumëllojshmërinë e furnizimeve me gaz natyror. Kështu do të rritej likuiditeti në tregun energjisë, dhe rajoni do të ishte më i qetë dhe i stabilizuar.

Bibliografia:

- Alkadiri, Raad ve Fareed Mohamedi. "World Oil Markets and the Invasion."
- Ari, Tassar. Irak, Gran ve ABD (Önleyici Savas, Petrol ve Hegemonya).
- Istanbul: Alfa Yayinlari, 2004. Aybars, Ergün. "Degisen Dünya Dengeleri İçinde Askeri ve Stratejik Açidan"
- Forbes, R. J. Studies in Early Petroleum History. Leiden: E. J. Brill, 1958.
- Friedland, Edward, Paul Seabury, Aaron Wildavsky. "Oil and the Decline of Eastern Poëer"
- Dakültesi Mecmuasi 3-4 (1976). Heykel, Muhammed. 3. Petrol Savasi: Körfez Savasi'nin Perde Arkasi.
- Petrolün Uluslararası İlişkilerdeki Yeri: Jeopolitik Teoriler ve Petropolitik
- Lieber, Robert J. "Oil and Poëer after the Gulf Ear." International Security No 1 (1982).
- Özbay, Fatih. "Realpolitik, Pragmatizm, Ulusal Çıkarlar ve Nükleer Program Ekseninde Dünden Bugüne Rusya-Iran ilişkileri"
- International Oil Companies And Governments In the Middle East." İçinde The Politics of Middle Eastern Oil. Editor J. E. Peterson. Eashington: Middle East Institute, 1983.
- Peterson, J. E. "Competing Superpoëer Interests in the Gulf."
- Saltıkgil, Haluk V. "Dünyada ve Türkiye'de Petrol: Ateşe Tapanlardan Petrole Tapanlara." Belgelerle Türk Tarihi Dergisi 28 (1970).
- Sayigh, Yusuf A. "Arab Oil Policies: Self-Interest versus International Responsibility." Journal of Palestine Studies Vol 4 No 3 (1975).
- Sloan, Geoffrey. "Sir Halford J. Mackinder: Geçmisten Günümüze Kalpgáh Kuramı" İçinde Strateji ve Coğrafya. Editör Colin S. Gray-Geoffrey Sloan. Ankara: ASAM Yayinlari, 2003.
- Yergin, Daniel. Petrol: Para ve Güç Çatışmasının Epik Öyküsü. Çeviren Kamuran Tuncay. Ankara: Türkiye İs Bankası Kültür Yayinlari, 1995.



Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes

Fan Noli, Rilindasi ynë i fundit

Intervistë me Prof. Pëllumb Xhufin me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së Fan Nolit

Albert Z. ZHOLI

Burrë shteti, poet, dramaturg, publicist dhe përkthyes, historian, kritik letrar dhe muzikolog, erudit poliglot, themelues i Kishës Autoqefale Shqiptare, F. S. Noli është gjeniu i kulturës shqiptare të shekullit XX. Një rrugëtim i gjatë tetëdhjetetrevjeçar, nga djepi ku e përkundi Gjyshe Sumba, në shtratin e prehjes së amshuar ku e përcolli nga larg një popull i tërë, nga një ngulim i humbur shqiptarësh në Ibrik Tepe, në kontinentin e ri, nga shkolla fillore greke e fshatit, ku e çoi të futur në thes Nënë Maria, në Harvard, nga përdorues vetëm i zhargonit shqip të katundit, në mjeshhtë të shqipes së kultivuar dhe njohës të nja dhjetë gjuhëve të huaja të tjera, nga sufler teatri, në foltoren e Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, nga Kryeministër i Shqipërisë në një azilant të ndjekur nga ankthi për bukën e gojës, nga përkthyes në greqisht i librit programor të Sami Frashërit për të shkuarën dhe të ardhmen e Shqipërisë, në shqipëruet të kryeveprave të letërsisë botërore, nga i dënuar me vdekje prej monarkisë dhe monarkut, në të pavdekshëm, kjo është jeta e F. S. Nolit. I madh dhe “i vogël”, stërnip i Davidit dhe nip i mëkatores, Gjyshes Sumba, Samson dhe filistin, kalorës i Skënderbeut tërë jetën, por ndonjëherë kalorës i Rosinantit, fitimtar dhe humbës, Mesi dhe prift katundi, hyjnor dhe tokësor, i perëndishëm dhe vdekatar, F. S. Noli jetoi një jetë dhe la një vepër mesazhi dhe morali i të cilave i kalon kufijtë e kohës së tij duke mbartur një vlerë e domethënie universale. Kalorës i dy utopive të mëdha dhe vuajtës prej tyre, me peshën e rëndë të Kryqit të Krishtërimit dhe të stërhalëve të vendit të vet, Noli njeri, artist e politikan, i kapërthyer midis kundërthëniesh e dilemash tragjike, i përballoi ato me filozofinë biblike të përkohësisë së fitimit të çastit dhe të përjetësisë së shembullit moral.



F. S. Noli jetoi një jetë dhe la një vepër mesazhi dhe morali i të cilave i kalon kufijtë e kohës së tij duke mbartur një vlerë e domethënie universale. Kalorës i dy utopive të mëdha dhe vuajtës prej tyre, me peshën e rëndë të Kryqit të Krishtërimit dhe të stërhalëve të vendit të vet, Noli njeri, artist e politikan, i kapërthyer midis kundërthëniesh e dilemash tragjike, i përballoi ato me filozofinë biblike të përkohësisë së fitimit të çastit dhe të përjetësisë së shembullit moral.

Shqiptare, 90-vjetorin e botimit të librit të tij “Histori e Skënderbeut”, 90-vjetorin e Revolucionit të Qershorit dhe 50-vjetorin e vdekjes së tij. Institucione, si Qendra e Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Historisë i Universitetit të Tiranës, apo Universiteti i Korçës, që mban edhe emrin “Fan Noli”, nuk organizuan asnjë aktivitet për kolosin e letrave e të patriotizmit shqiptarë, gjë që sigurisht nuk u bën nder atyre.

Si do ta cilësonit librin “Fan Noli-kryeministër”?

Duke iu kthyer botimit që u promovua para pak ditësh dhe që është një përmbledhje e kontributeve që u paraqitën një vit më parë në konferencën për Fan Nolin, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Fondacioni Fan Noli, do desha të përgëzoj kolegen, Prof. Kaliopi Naska, e cila bëri një paraqitje të plotë të këtij botimi. Nga ana ime, do doja të shtoj një refleksion timin, që më lind nga leximi i veprës së Nolit. Më duket se Nolin mund ta përkufizojmë me plot të drejtë si Rilindasin e fundit. E di, që me këtë emër kemi pagëzuar edhe të tjerë personalitete të nderuar të historisë sonë. Por më duket se Noli është Rilindasi i fundit par excellence.

Pse?

Sepse, sipas mendimit tim, Noli në mënyrë të ndërgjegjshme i vuri qysh në rininë e tij detyrë vetes të realizonte tre detyra, që Rilindja Kombëtare i kishte lënë të porealizuara.

Së pari, iu vu detyrës për të krijuar Kishën Autoqefale Shqiptare, që ishte një projekt i hershëm i tij. Qysh në 20 shkurt 1907, Noli ia tregonte me këto fjalë këtë projekt të tij një mikut të vet: “Meqënëse një nga ndalimet e mëdha për çështjen tonë është fanatizma që ka mbjellur priftëria dhe kjo fanatizmi sikundër është mbjellë prej priftërinjsh, gjithashtu duhet të tarret e të ç’rrenjoset prej priftërinjsh, me ndryshim se këta priftërinj duhet të jenë shqiptarë ortodoksë. U mejtua, pra, të themelojmë këtu në Boston një



Një ngjarje e veçantë

Botimi i librit “Fan Noli-kryeministër” përbën një ngjarje të veçantë. Libri është një përmbledhje e kontributeve që u paraqitën një vit më parë në konferencën shkencore për Fan Nolin, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Fondacioni Fan Noli, me rastin e 90-vjetorit të kryesimit të qeverisë shqiptare në gjysmën e dytë të vitit 1924, në okelion Fan S. Noli kryeministër, kumtesat që u mbajtën në këtë konferencë, duke e pasuruar atë me disa materiale të tjera. Në hartimin e librit, i cili publikohet nën siglën e botimeve “M&B”, kanë kontribuar studiues si akademik Jorgo Bullo, Dhimitër Anagnosti, president nderi i fondacionit Fan S. Noli, prof. dr. Nasho Jorgaqi, prof. dr. Paskal Milo, prof. dr. Pëllumb Xhufi, prof. dr. Hamit Kaba, prof. dr. Shaban Sinani, prof. Ksenofon Krisafi, studiuesja e re Danja Sinanaj etj. Ndërsa Prof. Kaliopi Naska ka meritën sepse bëri një paraqitje të plotë të këtij botimi.

kishë ortodokse shqip me prift shqiptar dhe me gjuhë mësimi shqipen”. Noli iu vu me pasion këtij misioni dhe e realizoi atë, në vitin 1921.

Së dyti, po në vitin 1921, Noli realizoi edhe atë që ai e konsideronte misionin e dytë të tij rilindas, botoi librin “Histori e Skënderbeut”. Frazja e parë e parathënies së shkruar nga ai vetë, thotë: “Qëllimi im kur shkrova këtë veprë, ishte t’i jap popullit tonë një histori të Skënderbeut dhe kjo libër duhet gjykuar kryesisht nga kjo pikëpamje... Shumë njeje të kësaj historie mbeten,

dhe unë shpresoj t’i çokklovis më vonë kur të kem përpara dokumente, të cilat të më japin fillin e Arianës”. Noli, pra, iu vu punës për realizimin e një historie të Skënderbeut, i nisur nga vetëdija patriotike e qytetare, që shqiptarët nuk mund të rriteshin pa njohur kryeherin e tyre, që duhet të ishte katalizatori i ndërgjegjes së tyre kombëtare. Por, ai ishte i ndërgjegjshëm, që vepra e tij e parë nuk kënaqte plotësisht kërkesat e një vepre të mirëfilltë shkencore, ndaj, siç kishte premtuar në parathënie e botimit të parë, ai iu

vu punës për realizimin e një botimi të dytë shkencor, që e realizoi me sukses në vitin 1947. Këtë projekt të tij Fan Noli e realizoi me shumë sukses dhe këtë e dinë mirë miqtë dhe armiqtë e tij, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Misioni i tretë rilindës i ndërje si i tillë nga Noli, ishte realizimi i një përmbysjeje sociale, që do sillte largimin nga skena e historisë e klasës së vjetër anadollake të bejlerëve, pashallarëve e bajraktarëve, e cila i kishte shërbyer për 500 vjet sundesve osmanë, duke shtypur e duke lënë në padituri popullin e vet. Qeveria e Ismail Qemalit, pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912, me përbërjen e saj me intelektualë e luftëtarë të radhëve të para të Rilindjes Kombëtare, ishte një hap i parë drejt realizimit të këtij misioni. Por, si rezultat i ndërhyrjes së qeverive monarkiste të Evropës e të Ballkanit, qeveria e Ismail Qemalit u rrëzua dhe qeveritë pasardhëse të Princ Vidit më 1914, të Durrësit më 1919 apo qeveritë e viteve 1921-1924 të dominuara nga figura e Ahmet Zogut, përfaqësonin një restaurim të rendit të vjetër feudal. Revolucionin e Qershorit, i realizuar nga Fan Noli dhe bashkëpunëtorët e tij, ishte një përpjekje madhore për t’i dhënë fund një herë e mirë të kaluarës feudale të Shqipërisë dhe për t’i hapur rrugë europianizimit të saj. Këtë mision, siç dihet, Fan Noli nuk mundi ta realizojë dot. Ajo mbeti për t’u realizuar në kushtet e ndryshuara të Luftës II Botërore, kur përfaqësuesit e elitës së vjetër shqiptare u vunë, për herë të fundit, në shërbim të pushtuesve nazi-fashistë të vendit të tyre, duke shënuar kështu edhe fundin e pashmangshëm të tyre. Jo pa arsye, Fan Noli u rreshtua në ato vite në krah të rinisë shqiptare, që mori armët për çlirimin e atdheut, duke e rreshtuar atë, për herë të parë, në krahun e duhur të historisë, në Aleancën e Madhe Antifashiste Botërore.



Sayeret Duvdevan: Njësia elitë kundër terroriste e Izraelit

Sayeret Duvdevan është një grup i Forca Speciale pjesë e Forcave të Mbrojtjes së Izraelit (IDF, Israeli Defense Forces) që konsiderohet si njësia me elitë kundërterroriste në Izrael. Të krijuar në vitin 1987, ata punuan fillimisht në fshehtësi në zonat urbane të Palestinës. Specialiteti i tyre është infiltrimi, arrestimi dhe kapja e militantëve të kërkuar. Në thelb, ata maskohen si palestinezë, duke u veshur dhe sjellë si ata dhe duke përdorur gjuhën dhe traditat e tyre, gjëra këto që i mësojnë gjatë trajnimit. Për të kuptuar tamam vendin e tyre në IDF, është e rëndësishme të kuptojmë se ku qëndrojnë ata në strukturën organizative të ushtrisë izraelite.

Struktura bazë e IDF

Struktura e përgjithshme e IDF konsiston: marinë, forcë ajrore, polici dhe është në vartësi të Forcave të Armatosura. Përveç kësaj, ekzistojnë gjithashtu edhe nën grupet. Forca Detare ka versionin e saj të SEALs, i quajtur S-13; Forca Ajrore ka njësinë e saj parashutiste, të quajtur "669"; Policia ka "YAMAM", të cilët janë kombinim i forcave SEAT dhe forcave të çlirimit të pengjeve. Forca Tokësore ka disa njësi autonome të cilat janë: MATKAL, të cilët merren me grumbullimin e informacionit, çlirimin e pengjeve dhe njësinë e zbulimit të largët (e ngjashme me Forcat Delta). PALSAR (e ngjashme me Rangers) është kryesisht njësi zbulimi, ata angazhohen gjithashtu në prita dhe zbulim të largët në nivel brigade. EGOZ është një njësi e luftës guerile dhe antiguerile. Ata përdorin prita, në veçanti kundër Hezbollahit. YAMAS është një njësi e fshehtë e policisë dhe, së fundmi, Duvdevan është një njësi KT (kundër terrorizmit) dhe kryen arrestime nëpërmjet infiltrimit. Me përjashtim të Duvdevan, të gjitha këto njësi në Izrael kanë misionet në kohë lufte, po ashtu siç kanë misionet të përditshme.

Historia e Duvdevan

Në 1987, shpërtheu kryengritja e parë palestineze (Intifada), duke çuar në një valë të re terrorizmit në territoret e reja. IDF është përballur me mijëra terroristë, të armatosur rëndë dhe që



gëzonin mbështetjen e plotë të palestinezëve. Për shkak të një imazhi tepër të komprometuar të marrëdhënieve publike, në shtypin botëror, një hakmarrje ushtarake në shkallë të gjerë ishte jashtë diskutimit. Në vitin 1987 filloi kryengritja e parë palestineze (Intifada) në Jabalia, një kamp refugjatësh dhe shumë shpejt u shpërnda përgjatë gjithë Gazas në Ëest Bank dhe në Jeruzalem. Palestinezët organizuan një lëvizje rezistence efektive, duke shënjestruar të gjithë izraelitët, duke përfshirë civilët, makinat, autobuzët dhe sulmet vetëvrasëse. Përveç këtyre, palestinezët ngritën barrikada përgjatë territorit, mbajtën bojkote, organizuan sulme të përgjithshme dhe refuzuan të paguajnë taksat. Gjatë intifadës së parë (1987-1993) rreth 160 izraelitë u vranë.

Në fillim të konfliktit, IDF praktikoi taktikat tradicionale të Forcave Speciale, çka doli të jetë një katastrofë e plotë. FS nuk ishin të përgatitur për të trajtuar këto situata. Kur IDF u përpoqën për të kryer detyrat e tyre gjatë ditës, ata ishin të rrethuar nga qindra palestinezë të dhunshëm, që shpesh shpërthyen në trazira në shkallë të plotë.

Përgjatë natës situata ishte më e rëndë. Ushtarët identifikoheshin lehtë prej miljesh larg, për shkak të uniformës dhe armëve të tyre të veçanta.

Kur ushtarët arrinin në shtëpitë e objektivave të tyre, ata gjendeshin bosh. Një njësi e fshehtë ishte e nevojshme që të mund të kryente misionet të shpejta dhe efektive dhe mbi të gjitha në thellësi. Ndryshe nga 1940, kur njësia Mistarvim (e fshehtë) u përdor si një mjet për mbledhjen e inteligjencës dhe gjithashtu për të lëvizur fshehurazi armë dhe pajisje, Mistarvim i ri ishin projektuar si

njësi CT (kundër terrorist) e pastër. Anëtarët e parë erdhën nga S-13 (marina izraelite), çka është e ilustruar si një spirancë në logon Duvdevan-së.

Duvdevan sot

Në fakt, njësia njihet me një numër identifikimi dhe emri Duvdevan është thjesht një nofkë që i është vënë njësisë. Njësitë komando të IDF njihen si "Katzefit", ose "kremi" ajka e më



të mirëve. Në historinë e shkurtër 20 vjeçar të Duvdevan, ajo ka qëndruar më lart dhe përtej njësive tradicionale të veçanta të IDF. Dhe ata mund të quhen qershia mbi krem, mbi tortë. Fjala Duvdevan, do të thotë qersh. Në vitin 2002, Duvdevan u nënshtrua disa ndryshimeve të mëdha. Ata u riorganizuan pas disa problemeve të brendshme, p.sh, incidenti i goditjes së forcave të veta, gjatë një misioni (friendly fire), vdekje për shkak të motit etj.

Këto ndryshime përfshinë:

1. Stërvitja bazë e njësisë u rivendos në kryej në bazën e parashutistëve, pasi më përpara kryej në mënyrë të pavarur në bazën Adam, së bashku me njësinë e shpëtimit, Njësia 669 dhe OKETZ (njësia e trajnimit dhe përdorimit të qenve). Pasi dy ushtarë vdiqën më trajnim, stërvitja bazë u delegua këmbësisht. Stërvitja bazë vazhdon 7 muaj dhe zhvillohet së bashku me Tzanchanim (parashutistët).

2. Njësi speciale, së bashku me Duvdevan, u formuan, por janë të klasifikuara.

3. Baza e njësive është rivendosur dhe rindërtuar gjithashtu. Tani ajo është e veçuar dhe e pavarur në një vend sekret. Ndryshe nga Duvdevan, shumica e Forcave të Mbrojtjes së Izraelit (IDF) kanë bazën e tyre brenda një baze më të madhe.

4. Së fundmi, procesi i seleksionimit për t'iu bashkuar njësive dhe për të filluar procesin prej një viti e gjysmë trajnimi u ndryshua nga një proces i pavarur dhe sekret seleksionimi, në një test motivimi me dy faza. Testi i parë, kur kandidatët janë ende civilë, zgjat 24 orë, testi i dytë zgjat 5 ditë, pasi rekrutët kanë hyrë në ushtri, test i cili ndiqet nga intervistat.

Njësia e gjen krenarinë e saj tek fakti i të qenit lider në operacionet kundër-terroriste në Izrael. Në vitin 2002 njësia u dekorua si e tillë nga kryeministri me motivacionin "për efikasitet në luftën kundër terrorit". Njësia Duvdevan shikohet si një nga njësitë kundër terroriste më të suksesshme në botë. Në janar 2008 njësia vrau në mënyrë të suksesshme një major të xhihadit islamik, komandant në West Bank.

Përgatiti: Kapiten Ervin HODO

NATO, pjesë e rëndësishme e një shoqërie të hapur dhe demokratike

Konferencë e përbashkët për shtyp e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg dhe Komandantit Suprem të Forcave Aleate për Europën, gjenerali Filip Breedlove

MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka diskutuar mbi sfidat e sigurisë me Komandantin Suprem të Forcave Aleate për Europën të NATO-s, gjeneralin Philip Breedlove, si dhe ka marrë pjesë në një konferencë të komandantëve të lartë ushtarakë gjatë vizitës në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate të Evropës, më 11 mars 2015. Ai falënderoi komandantët për punën e shquar të forcave aleate në mjedisin shumë kompleks dhe të ndryshuar të sigurisë. Stoltenberg paralajmëroi se veprimet agresive të Rusisë ndaj Ukrainës kanë dëmtuar pas Luftës së Ftohtë rëndin e sigurisë në Europë. Ai theksoi se armëpushimi në Ukrainën Lindore mbetet themeli më i mirë për një zgjidhje paqësore të konfliktit dhe theksoi se armëpushimi që po mbahet ka mbetur i brishtë. “Ne kemi parë tërheqjen e disa armëve të rënda, por është e paqartë se në ç’destinacion”, tha ai. Sekretari i Përgjithshëm i bëri thirrje të gjitha palëve për të siguruar që monitoruesit e OSBE-së të kenë “informacionin, lirinë e lëvizjes dhe garancitë e sigurisë që ata kërkojnë”, për të verifikuar përpunimin e plotë të marrëveshjes në Minsk. Në përgjigje të sfidave në të dy anët, në Lindje dhe Jug, NATO po zbaton përfundimin e fortë të mbrojtjes së saj kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë, tha Stoltenberg. “Ne jemi duke dyfishuar madhësinë e Forcës së Reagimit të NATO-s prej 13.000 deri në 30.000 trupa” dhe “ngritjen e një reagimi të ri të 5000 të fortë, të shpejtë të Forcës majë shtize, me disa njësi të gatshme për të lëvizur brenda në më pak se 48 orë”. Ai shtoi se NATO ka krijuar gjashtë qendra të komandës dhe kontrollit në shtetet baltike dhe në tre aleatët e tjerë lindore, në mënyrë që të koordinojë trajnimin dhe ushtrimin dhe lehtësojë përfundimin e shpejtë. Stoltenberg tha se Aleanca do të “ruajë shpejtësinë”, duke vënë në dukje një ushtrim aktual të anijeve të NATO-s në Detin e Zi, një vendosje të SHBA-së në rajonin e Baltikut për trajnim, si dhe një ushtrim të ardhshëm në vjeshtë, që pritet të jetë më i madhi i Aleancës prej shumë vitesh. “Këto masa janë mbrojtëse, proporcionale dhe në përpunim me angazhimet tona ndërkombëtare”, tha Stoltenberg, duke shtuar se “Zyra Qendrore dhe Komandanti ynë Suprem në Europë, Gjenerali Breedlove, luajnë një rol kyç në këto përpjekje”.

Gjenerali Philip Breedlove tha se, “ne jemi natyrisht të gëzuar që ju erdhët dhe jeni pjesëmarrës përsëri, që drejtues të lartë por dhe të thjeshtë të jenë me ju këtë mëngjes në shkëmbimin e ideve dhe mendimeve, ju falënderoj për dhënien e kohës grupit tim të udhëheqjes”. Ai theksoi se “gama e pjesëmarrësve ishte e gjerë në këtë konferencë, jo vetëm



komandantët por edhe udhëheqësit e lartë të Forcave Ajrore, Tokësore, Detare dhe Forcave të veçanta në të gjithë Aleancën”, duke shtuar se “ne gjithashtu kemi pjesëmarrës nga të tjera komanda strategjike, Komanda Aleate e Transformimit të NATO-s, ACT, që është një partneritet i fortë që ne kemi, jemi një gamë e gjerë e përkatësive, por jemi të bashkuar në një fokus që është zbatimimi i vendimeve të marra në Samitin e Uellsit”. Kërcënimet e terrorizmit nga të dy anët, në Lindje dhe Jug, tha gjenerali Breedlove “kanë bërë rishqyrtimin e strategjisë sonë të sigurisë dhe kështu ne jemi në aktivitet të plotë duke ecur përpara me sigurimin tonë dhe masat tona adaptuese dhe tezës sonë të Aleancës, për të bërë më shumë dhe për të qenë gati dhe të përgjegjshëm në të ardhmen”. Ai tha se komandantët sot e kuptojnë këtë sfidë shumë mirë, për të vazhduar e për të shkëmbyer pikëpamjet rreth praktikave më të mira dhe të eksplorojnë ide të reja për përmirësimin e aftësive. “Kam kaluar shumë vite duke shërbyer me aleatët tanë evropianë dhe jam i kënaqur të them se unë kurrë nuk kam parë një shkallë më të madhe të kohezionit, zgjidhje dhe vendosmëri për të siguruar që NATO është e gatshme për të përmbushur sfidat tona të ardhshme dhe unë jam i bindur se kjo do të vazhdojë që ne të mbrojmë të ardhmen tonë së bashku”.

Më poshtë, po sjellim për gazetën “Ushtria” pyetjet dhe përgjigjet e bëra në konferencën e përbashkët për shtyp të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg dhe gjeneralit Filip Breedlove.

Pyetje: Rusia është duke e dhënë fund aktivitetit sipas Forcave të Armatosura Konvencionale në Trak-

tatin e Evropës. Si do ta komentoni këtë, çfarë pasojë mund të ketë?

Jens Stoltenberg: Jemi të zhgënjyer nga vendimi i Rusisë për të pezulluar pjesëmarrjen në Grupin Këshillues bashkëngjitur Forcave të Armatosura Konvencionale në Traktatin e Evropës. Ne ende mbështesim të gjitha përpjekjet për kontrollin e armëve dhe ne besojmë se Traktati është i rëndësishëm dhe ky grup është organ këshillimor që mbledhet në Vjenë rregullisht për të diskutuar zbatimin e Traktatit CFE. Pra, ky veprim pason pezullimin e njëanshme të zbatimit të Traktatit të Rusisë në dhjetor 2007. Ne jemi të zhgënjyer që Rusia pezulloi pjesëmarrjen e saj sepse ne besojmë se për të pasur konsultime mbi kontrollin e armëve, reduktimet e armëve janë të rëndësishme.

Do të doja të dija mendimin tuaj mbi kërkesën e Ukrainës në OKB, drejtuar OKB-së për të dërguar misionin paqeruajtës në lindje të Ukrainës. A mendoni se kjo është ose jo ide e mirë dhe cila ju mendoni do të jetë më efektive?

Stoltenberg: Ajo që bëjmë ne është mbështetja fort e të gjitha përpjekjeve për të arritur një zgjidhje paqësore të negociuar, për këtë arsye ne mbështesim armëpushimin dhe theksojmë rëndësinë e tij dhe e respektojmë plotësisht, ne sigurisht mbështesim tërheqjen e armëve të rënda, kjo duhet të monitorohet, kjo është çështja kryesore, që të gjithë monitoruesit e OSBE-së duhet të kenë liri dhe qasje të plotë, qasje në informata. Ata kanë nevojë për garanci dhe siguri për të bërë punën e tyre. Mendoj se ajo që ne tani duhet të përqendrohemi është zbatimimi i Marrëveshjes në Minsk, armëpushimi dhe mbështetja e sistemit të themeluar për monitorimin e vëzhguesve të OSBE-së. Deri tani nuk ka

pasur kërkesa në bazë të marrëveshjes së rënë dakord midis palëve për çfarëdo forcë paqeruajtëse, kështu që është diçka që nuk duhet spekuluar. Ne do të ndjekim përpjekjet për të gjetur një zgjidhje paqësore të qëndrueshme dhe të gjitha mbështetjet për këtë.

Ju keni vendosur objekte të pritjes, pajisjet e infrastrukturës, trupa, etj, të gjitha së bashku në Evropën Lindore, që është gjë e mirë, por objektet e reja dhe aktivitetet që po planifikohen për krahun jugor të NATO-s, përtej ushtrimeve, janë vetëm thjesht detare?

Philip Breedlove: Sigurisht. Ka përmirësime që janë një pjesë e disa veprimeve që SHBA dhe NATO po marrin që të investojnë edhe në Jug. Siç e dini, ne kemi pjesë të infrastrukturës tonë të mirë përgjatë Mesdheut, që është për të na ndihmuar në masë të madhe, që ne të adresojmë shqetësimet që vendet tona kanë në jug. Unë mendoj se gjëja më e rëndësishme për të mbajtur mend është se ne e kemi marrë këtë vendim të rëndësishëm, siç Sekretari i Përgjithshëm foli më parë, se ne duhet të jemi në gjendje jo vetëm për të adresuar ato në lindje dhe në veri, por në jug dhe pastaj këto ushtrime, rotacioni i trupave, lëvizjet e anijeve që ndërveprojnë në jug për të sjellë siguri, pastaj dhe përshtatjet në jug janë të gjitha shumë të rëndësishme.

Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, tanke ruse dhe pajisje të rënda e kanë kaluar kufirin e Ukrainës gjatë disa ditëve të fundit, mund ta vërtetoni këtë dhe e konsideroni ju këtë në shkëlqje të Marrëveshjes në Minsk, Mister Stoltenberg?

Stoltenberg: Unë nuk do të shkoj në numra të veçanta, por ajo që unë mund të konfirmoj është se ne

kemi parë dhe ende e shohim praninë ruse dhe mbështetjen e fuqishme për separatistët në Ukrainën Lindore. Ne e shohim dorëzimin e pajisjeve, forcave trajnimin, kështu që Rusia është ende në Ukrainën Lindore dhe ata kanë një periudhë të gjatë që ofrojnë mbështetje të konsiderueshme për separatistët, për këtë arsye ne i bëjmë thirrje Rusisë për të tërhequr të gjitha forcat e saj nga Ukrainën Lindore dhe për të respektuar Marrëveshjen në Minsk. Fokusi kryesor megjithatë sot është se ne duhet të bëjmë gjithçka për të mbështetur zbatimin e armëpushimit dhe që vetëm nënvizon rëndësinë e Rusisë, tërheqjen e të gjitha forcave të saj nga Ukrainën Lindore dhe ndaljen e furnizimit me armë të separatistëve.

General Breedlove, ka pasur kritikë të shprehura në Gjermani në lidhje me politikën tuaj, informacionin se ju e ekzagjeroni pjesëmarrjen ruse në luftën në Ukrainë. Cili është reagimi juaj për këtë kritikë?

Sekretari Stoltenberg, jeni të shqetësuar se aleanca e NATO-s mund të mos jetë e bashkuar më në vlerësimin e përfshirjes ruse në Ukrainë?

Gjenerali Philip Breedlove: Ju falënderoj për pyetjen dhe mendoj se është e rëndësishme që ne të vazhdojmë të kemi një diskutim të hapur dhe bashkëpunues në lidhje me këto çështje. Ne e inkurajojmë këtë lloj të ndërveprimit, sigurisht 33 kombe marrin pjesë në çështjen tonë të inteligjencës. Ne kemi sigurisht 28 aleatët tanë dhe pastaj partnerët që bashkohen me ne dhe përdorin inteligjencën që ne kemi vënë së bashku në mënyrë kolektive në atë proces dhe kështu, me 33 të përfshirë jo gjithmonë do të ketë marrëveshje të saktë mbi çdo gjë. Në fakt inkurajojmë opinionet kundërshtues, sepse kjo sjell shtim të forcës për diskutimet tona dhe forcën për numrat që ne do të kemi. Kështu ne respektojmë të gjitha mendimet, pranojmë të gjitha mendimet dhe kemi vënë inteligjencën tonë së bashku në atë mënyrë. Mendoj se është një kohë e rëndësishme për të nxjerrë në pah gjithashtu komunikimin e të gjithë kombeve, por komunikimi i të gjithë komandantëve dhe komunikimi në mes Komandantëve Strategjikë dhe Sekretarit të Përgjithshëm është shumë i fortë, është i hapur është në vazhdim dhe ne diskutojmë këto çështje së bashku.

Jens Stoltenberg: Lidhur me pyetjen mbi NATO-n dhe unitetin unë do të doja të theksoj: NATO qëndron e bashkuar, NATO qëndron e bashkuar në përgjigjen tonë ndaj veprimeve agresive të Rusisë në Ukrainë, por në të njëjtën kohë unë mendoj se ju duhet të mbanini mend se NATO është një aleancë e 28 demokracive dhe kjo është një pjesë e rëndësishme e një shoqërie të hapur demokratike. Ka debate që janë vlerësime të ndryshme, mendime të ndryshme, pikëpamje të ndryshme, që për mua nuk është një shenjë e dobësisë, por ne jemi 28 shoqëri të hapura



demokratike që është në fakt një shenjë e fuqisë që jemi në gjendje që këto debate të hapura, vlerësime të ndryshme, pikëpamje të ndryshme brenda parlamentit, qeverive në të 28 aleatët. Për sa kohë që ne jemi në gjendje për të konkluduar të qëndrojmë së bashku në çështjet e rëndësishme dhe mesazhe, ne qëndrojmë së bashku me 28 aleatët. Gjenerali Breedlove, unë, të gjithë ata që janë në aleancën e NATO-s, kur është fjala për të dënuar veprimet agresive e Rosisë në Ukrainën Lindore, aneksimi i paligjshëm i Krimesë, ne qëndrojmë së bashku, po kështu kur është fjala për mbështetjen shumë të fortë për të gjitha përpjekjet për të gjetur një zgjidhje paqësore të negociuar për konfliktin në Ukrainën Lindore dhe rëndësinë e respektimit të armëpushimit. Ne qëndrojmë së bashku kur është fjala për zbatimin e përshtatjes më të madhe të strukturave të forcave që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Pra, ne qëndrojmë së bashku në mesazhin kryesor, çështje të rëndësishme, por ne mirëpresim debate të hapura demokratike dhe të shoqërive të hapura demokratike, sepse kjo është pjesë në të vërtetë e vlerave thelbësore të aleancës së NATO-s.

Si mendon secili prej jush për idenë e Presidentit të Komisionit Junker për krijimin e një ushtrie të BE, kur ju nuk mund të merrni 22 qëndrime të njëjta të këtyre qeverive, për të financuar operacionet e NATO-s? Dhe një pyetje tjetër për OSBE-në, lidhur me monitorim dhe verifikim të situatës në zonën e konfliktit dhe të dhënave të sakta.

Jens Stoltenberg: Në lidhje me pyetjen e parë. Është Bashkimi Evropian ai që vendos se si do ta organizojë kooperimin lidhur me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, por ajo që unë do të doja të theksoj është se është e rëndësishme për të shmangur dublimin dhe i bëj thirrje Evropës për të siguruar se çdo gjë që ata bëjnë është komplement për atë që ne bëjmë në aleancën e NATO-s, sepse ne duhet të punojmë së bashku dhe ne kemi për të shmangur dublikimin, për një mbrojtje të fortë në të dy aleancat dhe në bashkëpunimin mes NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Kur është fjala për lëvizjen e armëve unë mendoj se Phil do të jetë.

Gjenerali Philip Breedlove Po. Falënderoj Sekretarin e Përgjithshëm. Vetëm pak, në përgjigjen e parë, mendoj se ne kemi nevojë për të festuar bashkëpunim e madh që tashmë kemi me BE-në. Nëse ju shikoni në Operacionin Mbuoroja Oqeanike dhe ATALANTA dhe se si BE-ja dhe NATO-ja kanë punuar së bashku për të, në thelb, për bashkëpunimin për të eliminuar piraterinë në brigjet e Afrikës, shohim vazhdimin e ngushtë në Kosovë, ku KFOR dhe EULEX kanë adresuar me forcë disa çështje me të vërtetë të vështira atje. Mendoj se Sekretari i Përgjithshëm e ka përshtatur atë shumë mirë që ne nuk jemi të shqetësuar, por ajo që ne do të dëshironim për të shmangur ndonjë publikim, sepse ne kemi nevojë për të investuar me zgjuarsiri së bashku në mbrojtjen tonë të së ardhmes. Mendoj se ju e sollët problemin shumë mirë me OSBE-në, që është se ne, nuk kemi një pamje të mirë të asaj që ishte atje për të filluar me të. Kufiri mbetet i hapur

trupa ruse dhe çfarë janë aftësitë e tyre të akumuluarat përgjatë kufirit midis Ukrainës dhe Rosisë në momentin e tanishëm? A ka ndonjë ndryshim? Si mund të hyni në aftësitë e këtyre trupave ruse? Dhe pyetja e dytë si mendoni ju, e bën të vërtetë atë misioni i OSBE-së, në qoftë se është në gjendje të kontrollojë të paktën më shumë apo më pak disa pjesë të kufirit midis Ukrainës dhe Rosisë, sepse nga tani ajo është në gjendje për të vendosur kontrollin e saj vetëm në rreth 40 metra, ndërsa kufiri është 407 kilometra i gjatë? Zotëri e shihni këtë si sfidën kryesore dhe si mund të përmbushet?

Gjenerali Philip Breedlove: Pyetja e parë, a ka ndonjë ndryshim në numrat? Siç e kemi thënë disa herë këtu është e vështirë për të treguar. Lajm i mirë që Sekretari i Përgjithshëm ka vënë në dukje është se ne kemi parë disa lëvizje të armëve të rënda dhe disa prej trupave që ishin pranë vijës së kontaktit.

qasje të plotë në të dy anët e kufirit, por edhe zonën ku armëpushimi është menduar të zhvillohet duke përfshirë këtë linjë në zonën ku lëvizja e armëve të rënda është menduar të zhvillohet dhe siç kam theksuar në deklaratën time të asaj që ne kërkojmë është lëvizja e lirë e vëzhguesve të OSBE-së, por edhe ata të marrin qasje në të dhënat e nevojshme dhe natyrisht të marrin garanci sigurie të nevojshme në mënyrë që monitorimi i armëpushimit të jetë në mënyrë të mjaftueshme sot dhe kjo është arsyeja pse ky është një kyç, sepse në qoftë se ne duam që armëpushimi të jetë i qëndrueshëm dhe solid ne kemi nevojë për monitorim të përmirësuar të armëpushimit.

Gjenerali Breedlove sa kontrolli operacional do të keni mbi Forcën majë shtize dhe në çfarë mase do të varet dislokimi i saj në vendimin e qeverive aleate? Dhe për Sekretarin e Përgjithshëm, në atë masë që ky është një problem çfarë po bën për të rregulluar atë?

Gjenerali Philip Breedlove: Kjo është një pyetje e madhe, do të doja të filloj së pari duke iu përgjigjur, në atë se ka shumë theks, natyrisht, shumë të lartë gatishmërie në forcën tonë të përbashkët dhe përshtatjet e tjera, ne jemi duke e treguar atë në verilindje në Multi-National Core dhe NFIU, por të përqendrohemi në VJTF siç e quajmë ne, është e rëndësishme, por është gjithashtu e rëndësishme të mbani mend se kjo është një pjesë e një adaptimi më të gjerë në të gjithë forcën e reagimit të NATO-s, të të gjithë gatishmërisë sonë dhe të gjithë përgjegjshmërisë tonë, kjo do të përmirësohet që të na bëjë më të gatshëm dhe më të përgjegjshëm në të ardhmen e afërt. Gatishmëria shumë të lartë e VJTF cila është vetëm një pjesë e NRF, ne jemi në mes të diskutimeve se si SACEUR këtu do të jetë në gjendje për të adresuar çështjen e përgjegjshësisë.

Jens Stoltenberg: Vetëm për të shtuar dhe për të theksuar se në radhë të parë unë mendoj se vendimmarrja është kyçe sepse do të rrisë përgjegjshmërinë tonë dhe gatishmërinë e forcave tona, vendimmarrja është pjesë shumë e rëndësishme, mendoj se ne duhet të kujtojmë se ky është një element në gamë të gjerë të masave. Dhe një tjetër zonë e planit të veprimit të gatishmërisë e cila është gjithashtu e rëndësishme, rritja e mbikëqyrjes, zbulimi, intelijenca dhe arsyria pse ne jemi duke u fokusuar në atë që është e do të na sigurojë kuptim

më të mirë të situatës, bazë më të mirë për marrjen e vendimeve por edhe na jep kohë më të mirë për të marrë vendime për shkak të zbulimit të mirë, survejimi më i mirë do të rrisë kohën e paralajmërimit për shkak se ne do të kemi më shumë informacion dhe më herët. Dhe që në të vërtetë ka të bëjë me atë që ne po bëjmë në jug, sepse ne do të vendosim sistemin e parë global (SIC) apo Sistemet e Mbikëqyrjes Aleate Tokësore në Sicili, sistem i ri i NATO-s i cili do të rrisë vetëdijen tonë të situatës, kështu pjesë e vendimmarrjes është që të japë informacionin që na duhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe jemi në rritje të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe aftësive tona të zbulimit. Është hera e dytë që NATO ka provuar se është në gjendje për të bërë vendime të shpejta. Ka qenë vetëm disa ditë marrja e vendimit në NATO dhe Këshillin e Sigurimit të OKB-së në lidhje me mbrojtjen e civilëve në Libi dhe vendimin në NAC për të ndërmarrë veprime dhe për të dërguar aeroplanë në Libi. Dhe nënvizimi i tretë, shumë çfarë General Breedlove sapo tha, ne do të vlerësojmë do të vlerësojmë procedurat tona të vendimmarrjes dhe të sigurohemi se ato janë efektive, dhe, në të njëjtën kohë që ne jemi në gjendje për të ruajtur kontrollin politik, e cila është diçka që ne duhet të pajtohemi dhe që e kemi bërë edhe më parë, unë jam i sigurt se ne do të jemi në gjendje që të bëjmë edhe në të ardhmen.

A mund të na tregoni se çfarë vendimesh duhet të merrni ose çfarë vendimesh duhet të marrin vendet, për të mbajtur ritmin me planin tuaj të veprimit të gatishmërisë?

Jens Stoltenberg: Kjo është pjesë e planit të veprimit të gatishmërisë dhe ka elemente të ndryshme, unë nuk jam në gjendje t'ju tregoj datat e sakta tani, por kjo është në planin e ajo do të jetë diçka që ne jemi duke vlerësuar, por unë do të doja të theksoj se kjo nuk është krejtësisht e re, ne kishim Forcën e Reagimit të NATO-s edhe më parë, kështu që kjo është pjesë e adaptimit, ne jemi duke iu përshtatur forcat tona dhe procedurat tona të vendim-marrjes, por për nevojën që kemi të efikasitetit në marrjen e vendimeve dhe të kontrollit politik në të njëjtën kohë nuk është një sfidë e re për NATO-n. Ajo ka qenë atje për më shumë se 60 vjet dhe ne kemi qenë në gjendje për pajtimin e dy nevojave për më shumë se 60 vjet, unë jam i sigurt që ne do të jemi në gjendje të bëjmë atë edhe në të ardhmen.

Për Ukrainën, ju flisni për ju, që nuk e dini ku armët e tyre të rënda janë zhvendosur, do të thotë kjo që ju shihni një rrezik se ata në të vërtetë janë duke u ri pozicionuar për betejat e reja në rastin më të keq?

Jens Stoltenberg: Përgjigja e shkurtër është po. Pra, kjo është arsyeja pse është e rëndësishme për të marrë informacion të plotë për ku armët janë tani, numrat dhe ku ata janë të zhvendosur. Kjo sjell më mbrapa, mesazhin kryesor, se e mirëpresim armëpushimin dhe e mbështesim atë në zbatimin e armëpushimit dhe tërheqjen e armëve, por çelësi për të dy të respektojnë armëpushimin dhe duke u siguruar që armët e rënda janë lëvizur me të vërtetë siç është rëndë dakord në Marrëveshjen në Minsk është se monitorimi i armëpushimit është përmirësuar dhe prandaj ne kemi për të rritur OSBE-në apo mbështetur atë, për më shumë informacion, lirinë e lëvizjes dhe të garancive të sigurisë që ata kanë nevojë.

Gjenerali Philip Breedlove: Pjesë e madhe e suksesit të ardhshëm të armëpushimit do të ketë transparencë nga të gjithë anëtarët e përfshirë dhe, kështu, kjo është ajo që ne e shohim.



Armëpushimi në Ukrainën Lindore mbetet themeli më i mirë për një zgjidhje paqësore të konfliktit dhe theksoi se armëpushimi që po mbahet ka mbetur i brishtë. "Ne kemi parë tërheqjen e disa armëve të rënda, por është e paqartë se në ç' destinacion"

gjerësisht midis Ukrainës dhe Rosisë dhe lëvizjet janë të pashënura dhe të pakontrolluara dhe kjo është e vështirë për të kuptuar se çfarë është aty, ajo që vjen dhe shkon në forcat në lindje të vijës së kontaktit, ka fshehur lëvizjet e tyre, etj. Pra, është e rëndësishme që kur Sekretari i Përgjithshëm përmendi në grup të parë vërejtjet, është e rëndësishme që ne të kemi jo vetëm bashkëpunim në mënyrë që OSBE-ja mund të shkojë atje dhe të bëjë punën e saj, por ne të kemi bashkëpunim në atë që ne kemi nevojë të dimë të dhënat, kemi nevojë të dimë se sa dhe ku, është dhe kanë transparencë me OSBE-në, për të bërë këtë proces të lëvizjeve përpara, ne mbështesim plotësisht suksesin për progresin dhe të gjithë përpjekjet që përfshijnë fuqizimin OSBE-në që do të ndihmojnë që armëpushimi të ecë përpara.

Kam një pyetje për gjeneralin. Sipas të dhënave në dispozicion sa

Ne nuk jemi në gjendje në këtë pikë për të kuptuar ku ata kanë lëvizur, janë zhvendosur përsëri përtej kufirit rus, kanë lëvizur në vende të tjera, por sërish ne mbështesim progresin që është bërë dhe që është se ne shohim lëvizjen e armëve të rënda dhe trupat larg nga vija, por ne jemi të sigurt për çdo ndryshim në ndonjë nga numrat e fundit sepse prapë ne nuk jemi në gjendje të monitorojmë nga afër atë që po ndodh në Lindje. Për pyetjen tuaj në kufi, unë mendoj siç kam thënë më parë, tani për tani ne nuk e dimë se çfarë po ndodh në këtë kufi sepse, ashtu si ju nxirrni në pah, kufiri është shumë e shumë i hapur në gjerësi, kjo është dhe një pjesë e madhe e Marrëveshjes në Minsk, që të përpiqen të rikrijojnë atë kufi. Ne do të mbështesim edhe në të ardhmen dhe mendojmë se është e rëndësishme.

Jens Stoltenberg: Vetëm për të theksuar mesazhin tonë kryesor, sot është që OSBE-ja ka nevojë të ketë



Në Qendrën e Simulimit ka nisur stërvitja "Sardenja 15"

Në kabinetet dhe ambientet e Qendrës së Simulimit ka ngritur siparin stërvitja "Sardenja 15". Në këtë stërvitje marrin pjesë rreth 100 forca pjesë të shtabit të FT, Batalionit të Dytë të Këmbësorisë, si dhe Batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcës Tokësore. Fokusi i kësaj stërvitjeje do të jetë përgatitja e Batalionit të Dytë të Këmbësorisë të Forcës Tokësore për pjesëmarrje në NATO FTX "Trident Juncture-15", që do të zhvillohet në Sardenja të Italisë, ku do të marrin pjesë edhe disa vende të tjera anëtare të NATO-s. Në këtë stërvitje do të planifikohen dhe detytrat e mëvonshme të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë si forcë reaguese e NATO-s në vitin 2016. Synohet që nëpërmjet kësaj stërvitjeje, të rriten aftësitë e bml të formuar rishtas si Batalion i Mbështetës i Luftimit të Forcës Tokësore. Qëllimi i stërvitjes është që të planifikohet dhe të ekzekutohet një stërvitje për vendimmarrje në Vend Komandë (CPX/CAX) që të jetë e thjeshtë dhe efektive në nivelin taktik dhe të adresojë në të njëjtën kohë nevojat për trajnimin dhe zhvillimin e dy audiencave stërvitore të rëndësishme. Si audiencë parësore në këtë stërvitje janë shtabet e batalioneve, ndërsa si audiencë dytësore stërvitore janë shtabet e kompanive të batalioneve të FT, si dhe Qendra e Simulimit. Me këtë stërvitje synohen të arrihen objektivat kryesore të trajnimit që janë ato të zbatimit të procedurave të vendimmarrjes ushtarake; planizimi dhe zhvillimi i procedurave standarde të komandim-kontrollit; zbatimi i procedurave standarde për operacionet e llojeve të ndryshme nga shtabet e batalioneve etj. Forcat, llojet e operacioneve luftarake, aktivitetet logjistike, si dhe veprime të tjera janë paralele sa të jenë të mundura, si të stërvitjes NATO FTX "TRIDENT JUNCTURE 15". Stërvitja "Sardenja 15" përfundon më 20 mars 2015.

Nënkolonele Alda Sula

